

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETII MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Znj. PRANVERA KRISTANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

NË MJEKËSI KLINIKE

**TEMA: KOMPLIKACIONET NË TË SËMURËT ME CIRROZË HEPATIKE,
VLERËSIMI I PARAMETRAVE KLINIKE E BIOLOGJIKË, MENAXHIMI DHE
ECURIA E KOMPLIKACIONEVE NË PROGNOZËN E CIRROZËS**

Udhëheqës Shkencor: Prof. Adriana Babameto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Znj. PRANVERA KRISTANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

NË MJEKËSI KLINIKE

**TEMA: KOMPLIKACIONET NË TË SËMURËT ME CIRROZË HEPATIKE,
VLERËSIMI I PARAMETRAVE KLINIKE E BIOLOGJIKË, MENAXHIMI DHE
ECURIA E KOMPLIKACIONEVE NË PROGNOZËN E CIRROZËS**

Udhëheqës Shkencor: Prof. Adriana Babameto

MBROHET ME DATE...../....2022 PARA JURISË

1. _____ **KRYETAR**
2. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
3. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
4. _____ **ANËTAR**
5. _____ **ANËTAR**

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| PARATHENIE | 5 |
| FALENDERIME | 6 |
| SHKURTESA | 6 |
| I. HYRJE | 7 |
| 1 Pwrkufizim | 7 |
| 2 Epidemiologjia | 8 |
| 3 Etiologjia e Cirrozws Hepatike | 10 |
| 4 Mekanizma Fizpatologjikë të Cirrozës Hepatike | 12 |
| 4.1 Fzpatologjia e Cirrozës së Kompensuar | 12 |
| 4.2 Fizpatologjia E Cirrozës Së Dekompensuar | 14 |
| 5 Komplikacionet Në Cirrozën Hepatike | 17 |
| 5.1 Asciti | 17 |
| 5.2 Hidrotoraksi Hepatik | 26 |
| 5.3 Hyponatremia | 27 |
| 5.4 Hemorragjia Gastro-Intestinale | 31 |
| 5.5 Peritoniti Bakterial Spontan | 41 |
| 5.6 Sindromi Hepatorenal (HRS) | 46 |
| 5.7 Insufiçienca Hepatike Akute E Mbivendosur Mbi Atë Kronike (Aclf) | 53 |
| 5.8 Kardiomiopatia Cirrotike | 55 |
| 5.9 Encefalopatia Hepatike | 57 |
| 5.10 Sindroma Hepatopulmonare | 61 |
| 5.10.2 Diagnoza | 62 |
| 5.10.3 Trajtimi | 62 |
| II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT | 62 |
| 2.1 Qëllimi dhe objektivat e studimit | 62 |
| 2.2 Objektivat e përgjithshme | 64 |
| 2.3 Hipotezat e studimit | 65 |
| III METODOLOGJIA | 65 |
| 3.1 Tipi (ose lloji) i studimit | 65 |
| 3.2 Periudha kohore e kryerjes (realizimit) të punimit shkencor | 67 |
| 3.3 Popullata në studim | 67 |
| 3.4 Mbledhja e të dhënave | 68 |

| | | |
|-------------|---|------------|
| 3.5 | <i>Përkufizimi i variablave</i> | 69 |
| 3.6 | <i>Analiza Statistikore</i> | 71 |
| IV | REZULTATET | 72 |
| 4.1 | <i>Përshkrimi i Karakteristikave Demografike të Pacientëve me Komplikacione të Cirrozës Hepatike</i> 72 | |
| 4.2 | <i>Shpërndarja e faktorëve të riskut tek pacientët me Komplikacione të Cirrozës Hepatike</i> | 75 |
| 4.3 | <i>Përshkrimi i Karakteristikave Klinike të Pacientëve me Komplikacione të Cirrozës Hepatike</i> | 81 |
| 4.4 | <i>Komplikacionet e Cirrozës Hepatike si pasojë e dilatacionit arterial dhe qarkullimit hiperdinamik.</i> 85 | |
| V | DISKUTIM | 99 |
| VI | PERFUNDIME | 102 |
| VII | REKOMANDIME | 103 |
| VIII | BIBLIOGRAFIA | 104 |

Parathënie

Arkitektura normale e mëlçisë është e ndërtuar nga trabekula të rregullta të hepatociteve, e hapësirave portale dhe venave centolobulare. Cirroza është përcaktuar si një çorganizim difuz i arkitekturës të mëlçisë, me fibrozë unazore që kufizon noduj me grupe hepatocitesh, të quajtur noduj të rigjenerimit. Në disa raste, nodujt janë më të mëdhenj dhe kjo për makronoduj.

Të gjitha sëmundjet kronike të mëlçisë, pavarësisht nga shkaqet mund të çojnë në formimin e cirrozës nëse ecuria e tyre është e zgjatur. Zakonisht cirroza formohet vetëm pasi të kenë kaluar të paktën 10 deri në 20 vjet të evolucionit të një sëmundjeje kronike. Gjatë ecurisë kronike të sëmundjes së mëlçisë, fibroza shtrihet gradualisht, bëhet arkuate dhe përfundimisht kufizon nodujt e rigjenerimit, të cilët paraqesin pamjen karakteristike në cirrozë. Ajo karakterizohet nga shunte të enëve të gjakut mes degëve të venës porta dhe arteries hepatike nga njëra anë, dhe me venat centrolobulare nga ana tjetër. Përveç kësaj, ekziston një ndryshim i kapilarëve sinusoidalë, të cilët në kushte normale kufizojnë trabekulat hepatocitare. Endoteli humbet fenestrimet dhe kolagjeni depozitohet në hapësirën e Disse, e cila zakonisht kufizohet me trabekulat e hepatociteve dhe endotelin. Si përfundim, kur cirroza është instaluar, hepatocitet humbasin lidhjen e tyre normale me strukturat biliare e vaskulare. Këto modifikime të strukturës së mëlçisë, janë përgjëgjëse për dëmtimet e funksionit të mëlçisë. Në varësi të fazës evolutive dhe shkakut të sëmundjes, madhësia e mëlçisë mund të jetë e rritur, normale ose e ulur (atrofike). Konturet e mëlçisë janë të çrregullta, zonat hipertrofike bashkëekzistojnë me ato atrofike.

Në parim, diagnoza e cirrozës vihet bazuar në ekzaminimin histologjik të indit hepatic. Në praktikë, cirroza mund të diagnostikohet nga ekzaminimi klinik, ekzaminimet e thjeshta biologjike dhe imazheria. Në shumicën e rasteve, diagnoza e cirrozës mund të vendoset kur egzistojnë shenjat e hipertensionit portal dhe insuficienca hepatike, pa patur nevojën e ekzaminimit histologjik.

Falenderime

Së pari, kam kënaqësinë të falenderoj për zemërsisht udhëheqësen time shkencore, Prof. Adriana Babameto për mbështetjen e vazhdueshme profesionale përgjatë gjithë periudhës së këtij studimi shkencor dhe sidomos shkrimit të dizertacionit përfundimtar.

Falenderime edhe për të gjithë kolegët e Shërbimit të Gastroenterologjisë, Spitali Rajonal Durrës si dhe shërbimi Gastroenterologjisë QSUT për mjedisin shumë të favorshëm profesional, njerëzor dhe bashkëpunues, që më kanë inkurajuar dhe stimuluar përgjatë gjithë procesit dhe etapave të këtij studimi shkencor të ndërmarrë në kuadrin e programit të doktoraturës.

Por, falenderimet më të ngrohta dhe më të veçanta i'a kushtoj familjes sime të shtrenjtë, bashkëshortit, fëmijëve, dhe prindërve të mi, të cilët më kanë dhënë një ndihmë dhe mbështetje morale të jashtëzakonshme përgjatë gjithë periudhës së studimit tim shkencor dhe përbushjes me sukses të dizertacionit përfundimtar.

SHKURTESA

| | |
|-------|---|
| DAA | <i>Direct-acting antivirals</i> |
| AADR | <i>Age adjusted death rate</i> |
| NAFLD | <i>Non alcoholic faty liver disease</i> |
| HBV | <i>Hepatit Viral B</i> |
| HCV | <i>Hepatit Viral C</i> |
| NASH | <i>Non alcoholic steatohepatitis</i> |
| HCC | <i>Hepatocarcinoma</i> |
| LSECs | <i>Qelizat endoteliale sinusoidale</i> |
| KCs | <i>Qelizat Kuppfer</i> |

| | |
|-------|--|
| HSCs | <i>Qelizat stellate</i> |
| NF | <i>Faktorin aktiv nuklear</i> |
| RAAS | <i>Renin-angiotensin- aldosteron</i> |
| ACLF | <i>Insuficiencën akute mbi kronike</i> |
| HVPG | <i>Gradienti i presionit venoz hepatic</i> |
| HTP | <i>Hipertensionin portal</i> |
| VEGF | <i>Faktorin vaskular endothelial të rritjes</i> |
| HRS | <i>Sindromi hepatorenal</i> |
| BT | <i>Translokacioni bakterial anormal</i> |
| G-I | <i>Gastrointestinal</i> |
| TIPS | <i>Shuntin transjugular intrahepatik portosistemik</i> |
| KID | <i>Koagulimi intravaskular i diseminuar</i> |
| INR | <i>Raportet të normalizuar ndërkombëtare</i> |
| SBP | <i>Peritonitin Bakterial Spontan</i> |
| LDH | <i>Lactat hidrogjenaza</i> |
| SAAG | <i>Serum albumin ascit</i> |
| CEA | <i>Antigjeni carcinoembryonic</i> |
| PTFE | <i>politetrafluoroetilenit</i> |
| GRF | <i>Ritmi i filtrimit glomerular</i> |
| MELD | <i>Modeli end-stage të sëmundjes së mëlçisë</i> |
| LVP | <i>Large volume paracentezis</i> |
| PPCD | <i>Mosfunksionimi i qarkullimit të gjakut pas paracentezës</i> |
| SIADH | <i>Sindromin e çrregullimit të sekretimit të hormoneve antidiuretike</i> |
| HV | <i>Hemorragjia Variçeale</i> |
| EGD | <i>Ezofago-gastroduodenoskopia</i> |
| AASLD | <i>Shoqata Amerikane për Studimin e Sëmundjeve të Mëlçisë</i> |
| EBL | <i>Ligaturën Endoskopike</i> |
| NSBB | <i>Non-selective beta-blockers</i> |
| HE | <i>Encefalopatia hepaticke</i> |
| HPS | <i>Sindromi Hepatopulmonar</i> |

I. HYRJE

1 PËRKUFIZIM

Cirroza hepaticke përkufizohet si një zhvillim histologjik i nodujve të rigjenerimit, të rrethuar nga shiritat fibroze në përgjigje të një dëmtimi kronik të heparit, gjë e cila con në hipertensionin portal dhe më pas në cirrozën hepaticke të dekonpensuar (end stage liver disease) (1). Arkitektura normale e mëlçisë është e ndërtuar nga trabekula të rregullta të hepatociteve, e hapësirave portale dhe

venave centolobulare. Cirroza është përkufizuar si një çorganizim difuz i arkitekturës normale të mëlçisë, me fibrozë anulare (unazore) që kufizon noduj me grupe hepatocitesh, të quajtur noduj të rigjenerimit. Të gjitha sëmundjet kronike të mëlçisë, pavarësisht nga shkaqet mund të çojnë në formimin e cirrozës nëse ecuria e tyre është e zgjatur. Zakonisht cirroza formohet vetëm pasi të kenë kaluar të paktën 10 deri në 20 vjet të evolucionit të një sëmundjeje kronike. Të gjitha sëmundjet kronike të mëlçisë, pavarësisht nga shkaqet mund të çojnë në formimin e cirrozës nëse ecuria e tyre është e zgjatur. Gjatë ecurisë kronike të sëmundjes së mëlçisë, fibroza shtrihet gradualisht, bëhet arkuate dhe përfundimisht kufizon nodujt e rigjenerimit, të cilët paraqesin pamjen karakteristike në cirrozë (2).

Cirroza hepatike është gjerësisht e përhapur në mbarë botën dhe mund të jetë një pasojë e shkaqeve të ndryshme, sic mund të jenë obeziteti, sëmundja yndyrore joalkolike e mëlçisë, sëmundja alkolike e mëlçisë, hepatiti viral B ose C, hepatiti autoimun, sëmundjet kolestatike dhe mbingarkesa e hekurit ose bakrit. Cirroza zhvillohet pas një perudhe të gjatë të inflamacionit që rezulton në zëvendësimin e parenkimës së shëndetshme të heparit nga indi fibrotik dhe nodulet e rigjenerimit, duke çuar për rrjedhojë në hipertensionin portal. Më pas sëmundja evolon nga faza asimptomatike (*cirroza e kompensuar*) tek një fazë simptomatike (*cirroza e dekompensuar*), komplikacione që shpesh kërkojnë hospitalizim, prishje të cilësisë së jetës dhe mortalitet të lartë. Menaxhimi i cirrozës është përqëndruar në trajtimin e shkaqeve të cirrozës dhe komplikacioneve të saj si dhe transplantit hepatic i cili mund të indikohet për raste të caktuara (4).

Cirroza është një rezultat terminal i sëmundjes kronike të mëlçisë. Vitet e fundit, trajtimi mjekësor për cirrozën hepatike ka shënuar progres. Menaxhimi i cirrozës hepatike ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Për shëmbull, terapia antivirale për hepatitin C ka ndryshur ndjeshëm falë ardhjes së antiviralëve të rinj oral (DAA), por menaxhimi i cirrozës ka mbetur një çështje e rëndësishme edhe pas eradicimit të hepatitit C. Gjetje të reja janë raportuar në 5 vitet e fundit përsa i përket trajtimit të cirrozës hepatike virale B me analogët e rinj të acidit nukleik (3).

Cirroza hepatike është potencialisht reversibile përmes menaxhimit të shkakut. Ndërsa sëmundja e mëlçisë progreson, cirroza e kompensuar (asimptomatike) mund të dekompensohet duke shkaktuar ascit, encefalopati hepatike ose hemoragji nga varicet e ezofagut. Cirroza diagnostikohet thjesht me anë të historisë së sëmundjes, egzaminimit fizik dhe testeve joinvazive të cilat përfshijnë testet laboratorike, egzaminimeve imazherike si ekografia, elastografia. Biopsia e heparit mbetet një referencë standarte për cirrozën. Duhet të përdoret kur rezultatet e egzaminimeve joinvazive janë të paqarta, kur etiologjia e sëmundjes së mëlçisë mbetet e panjohur ose kur rezultatet mund të ndikojnë mbi trajtimin (5).

2 EPIDEMIOLOGJIA

Cirroza e mëlçisë është shkaku kryesor i mortalitetit dhe morbozitetit në mbarë botën, është shkaku i 11 kryesor i vdekjeve dhe i 15- ti shkaktar i sëmundshmërisë, duke përfshirë 2.2% të vdekjeve

dhe 1.5% te viteve të jetës të përshtatura me aftësinë e kufizuar në mbarë botën në vitin 2016. Sëmundja kronike e mëlçisë shkaktoi 1.32 milion vdekje në 2117. Afërsisht dy të tretat tek meshkujt dhe një e treta tek femrat (6).

Historikisht hepatiti viral B ka qenë shkaku kryesor etiologjik i cirrozës hepatike. Megjithatë strategjitë e përmirsuara të parandalimit si në rastin e hepatitit B dhe trajtimit, në rastin e hepatitit C, kanë çuar në përmirësimin e trendeve të cirrozës hepatike. Kjo është reflektuar në rënien globale, gjë e cila është vërejtur në shkallën e vdekshmërisë nga cirroza gjatë 30 viteve të fundit. Në mënyrë të veçantë, shkalla e sëmundshmërisë e rregulluar sipas moshës (AADR), nga cirroza hepatike ka rënë nga 21 në 16.5 për 100.000 banore nga viti 1990 deri në 2017(7).

Rajoni i Europës është konsumatori më i madh i pijeve alkolike në botë dhe përpjekjet për të reduktuar konsumin e alkoolit kanë ngecur në shumë vende. Po kështu, obeziteti është rritur pothuajse në çdo vend që nga viti 2013 dhe shkalla e sëmundjes yndyrore jo alkolike (NAFLD) po rritet ndjeshëm vitet e fundit. Në jug dhe lindje të Europës, hepatiti viral B mbetet shkaktari kryesor i vdekshmërisë nga cirroza hepatike (8).

Sëmundja e mëlçisë vret shpejt; dy të tretat e të gjithë viteve potencial të jetës humbasin për shkak se sëmundja kronike e mëlçisë progreson ngadalë përgjatë viteve të jetës. Ky është një kontrast me sëmundjet e tjera, siç është Stroke, ku pjesa më e madhe e vdekjeve ndodhin pas moshës 65 vjeç (9)

Të dhëna mbi prevalencën aktuale dhe historike si dhe vdekshmëria nga burimet e publikuara dhe të dhënat ndërkombetare, sugjerojnë se sëmundja është e kosiderueshme dhe një problem në rritje i shëndetit publik në vendet e Europës.

Disa rajone të Europës janë vlerësuar të kenë më shumë se 1100 raste prevalente të cirrozës dhe sëmundjeve të tjera të mëlçisë për 100.000 banorë (10). Të dhënat europiane të vdekshmërisë tregojnë se mesatarisht dy të tretat e vdekjeve ndodhin në individët përpara moshës 65 vjeç (11).

Rritja e prevalencës në vendet e Europës veriore dhe atë lindore siç është Mbretëria e Bashkuar dhe Rusia duken të jenë të lidhura me përdorimin e alkoolit , me një rritje ekuivalente të sëmundjes kronike të mëlçisë (12). Numri absolut i rasteve të sëmundjes kronike të mëlçisë (duke përfshirë çdo stad të sëmundjes) është afërsisht 1.5 bilion në mbarë botën(13).

Shkaku më i zakonshëm që prevalon është NAFLD (59%), ndjekur nga HBV(29%), HCV (9%), dhe hepatiti autoimun (2%) (14).

Sëmundje të tjera përfshijnë kolangiti biliar primar, kolangiti sklerotizant primar, defiçiti i alfa-1 antitripsines, Morbus Wilson dhe hepatiti autoimun që përbëjnë 1% të rasteve.

Reduktimi i mortalitetit në sëmundjen kronike të mëlçisë varion ndërmjet regjioneve dhe reflekton qasjet e çdo vendi për parandalimin dhe trajtimin e hepatitit viral.

Nga 1980 deri në 2010, mortaliteti u ul sinjifikisht në vënde si Kina (66% reduktim i AADR nga 43 në 16 për 100.000) dhe në Shtetet e Bashkuara (24% reduktim nga 15 në 11 për 100.000 banorë) kjo për shkak të parandalimit të hepatitit B.

Ndërkohë, vende të tjera kanë eksperiencë në uljen sinjifikante të mortalitetit: një shëmbull i tillë është Egjipti me 26 % reduktim të AADR nga 98 në 72 për 100.000 banorë si rezultat i një sforcimi të madh duke trajtuar hepatitin kronik viral C dhe schistosomiasis.

Nga ana tjetër, ka rajone që kanë experiencë në rritjen e mortalitetit si p.sh në Mongoli AADR është rritur në 24% (44-55 për 100.000) dhe në Indi (17-20 per 100.000), për shkak të rritjes së ndjeshme të hepatitit viral dhe konsumimit të alkolit (15).




Figura 1. Të dhëna epidemiologjike mbi faktorët predispozues të cirrozës hepatike përgjatë viteve 1990-2017.

3 ETIOLOGJIA E CIRROZËS HEPATIKE

Etiologjia e cirrozës zakonisht mund të identifikohet nga historia e pacientit e kombinuar me vlersimin serologjik dhe histologjik.

Sëmundja alkolike e mëlçisë dhe hepatiti C janë shkaqet më të zakonshme në botën perëndimore, ndërsa hepatiti B prevalon në shumë rajone të Azisë dhe Afrikës sub-sahariane. Pas identifikimit të hepatitit C në 1989 dhe steatohepatitit joalkolik (NASH) në pacientët obezë dhe diabetikë,

diagnoza e cirrozës pa një shkak të dukshëm (cirroza kriptogjene) është vënë rrallë. Është e rëndësishme të njihet etiologjia e cirrozës, pasi mund të parashikojë komplikacionet dhe trajtimin përkatës.

Lejon gjithashtu diskutimin e masave parandaluese, për shëmbull me antarët e familjes së pacientit me cirrozë alkoolike ose hepatiti kronik viral, dhe konsiderimin e testeve gjenetike dhe këshillave parandaluese për të afërmit e pacientit me sëmundje gjenetike, siç është hemokromatoza dhe Morbus Wilson.

Shpeshherë faktorë të shumfishtë etiologjikë kontribuojnë në zhvillimin e cirrozës, siç ilustron në studimet epidemiologjike që identifikuan konsumin e rregullt (të moderuar) të alkoolit, moshën mbi 50 vjeç, seksin mashkull si faktorë rreziku në hepatitin kronik C (16,17); apo obezitetin në moshë të vjetër, insulinorezistencën/diabeti tip 2, hipertensionin dhe hiperlipidemia (të gjitha shenjat e sindromit metabolik në NASH) (18,19).

Për më tepër, studimet kanë raportuar se etiologji të ndryshme kanë tendencë të rezultojnë në komplikime të ndryshme; për shembull, HCC ndodh më shpesh në raste të hepatitit viral në cirrozën hepatike sesa në rastet e alkoolit dhe të cirrozave autoimmune.(20)

Në vendin tonë infeksioni kronik nga virusi i hepatitit B deri disa vite më parë ka qënë shkaku kryesor i cirrozës hepatike. Dy-tre dekadat e fundit si pasojë e ndryshimeve ekonomiko-sociale vërehet rritje e konsumimit të pijeve alkoolike në grupmosha të ndryshme të popullatës, duke bërë që të ndryshojë raporti i faktoreve etiologjike, në pothuaj 50% me 50% në Cirrozat me etiologji Alkoolike dhe atyre Virale (21).

Cirroza mund të arrijë si pasojë e një procesi egzogjen/toksik, infeksioz, toksik/alergjik, imunopatologjik/autoimun ose një defekt i lindur i metabolizmit (22).

Shkaktarët kryesorë të Cirrozës hepatike janë: Alkooli, Hepatiti B, Hepatiti C dhe Steatohepatiti joalkoolik (NAFL). Një numër i shkaqeve më pak të zakonshme të cirrozës përfshijnë Hepatitin autoimun, Kolangitin primar sklerotizant, Hemokromatozën, Morbus Wilson, Çrregullime gjenetike, Medikamente të caktuara, Infeksione të caktuara, Cirrozën biliare primare, Fibrozën Cistike, Deficitin e α -1 antitripsinës, Çrregullime në metabolizmin e karbohidrateve (Galaktozemia dhe sëmundje të depozitimit të Glikogjenit).




Figura 2. Paraqitje skematike e shkaktarëve të Cirrozës Hepatike

4 MEKANIZMA FIZPATOLOGJIKË TË CIRROZËS HEPATIKE

4.1 FIZPATHOLOGJIA E CIRROZËS SË KOMPENSUAR

Mëlçia është e formuar nga qelizat parenkimale (hepatocitet) dhe qelizat e tjera që zakonisht njihen si qelizat joparenkimale. Muret e sinusoidave hepatike janë të rrethuara nga tre qeliza të ndryshme joparenkimale: qelizat endoteliale sinusoidale (LSECs), qelizat Kuppfer (KCs), dhe qelizat stellate (HSCs). Si qelizat hepatike parenkimale dhe ato joparenkimale janë të përfshira në fillimin dhe progresin e fibrozës dhe më pas të cirrozës (23).

Hepatocitet janë qelizat primare parenkimale, dhe luajnë një rol të komplikuar në procesin e fibrozës dhe cirrozës. Hepatocitet janë target për shumë nga agjentet toksikë, duke përfshirë viruset hepatotrope, metabolitet e alkoolit dhe acidet biliare (24). Sëmundjet kronike të heparit nxisin si apoptozën qoftë rigjenerimin kompensator të hepatociteve (25).

Hepatocitet e dëmtuara çlirojnë sasi oksigjeni reaktiv dhe mediatorët fibrogjenik, indukojnë aktivizimin e HSCs, dhe stimulojnë veprimin fibrogjenik të miofibroblasteve (24). Apoptoza e hepatociteve është një ngjarje në dëmtimin hepatic dhe kontribuon në inflamacionin indor, fibrogjenezën dhe zhvillimin e cirrozës. Steatohepatiti rrit apoptozën e hepatociteve, e cila korrespondon me faktorin aktiv nuklear (NF) dhe severitetin e sëmundjes (26). Si hepatiti viral C edhe konsumi i etanolit nxisin apoptozën hepatike në njerëzit (27). Infeksioni kronik nga HCV mund të dëmtojë funksionin hepatoqelizor dhe kufizojnë rigjenerimin

hepatic (28,29). Në dëmtimin hepatic nga karbon tetrakloridi, apoptoza e hepatociteve fillon në fazë të hershme, e cila ndiqet nga proliferimi konstant dhe nëse persiston cirroza hepatike futet në një stad më të avancuar (30).




Figura 3. Ndryshimet vaskulare dhe arkitekturore në mikroskopinë e cirrozës hepatike




Figura 4 : Mekanizmat fizpatologjikë të zhvillimit të fibrozës hepatike

Fibroza përshkruan inkapsulimin ose zëvendësimin e indit të dëmtuar nga shirita kolagjeni. Fibroza e mëlçisë rezulton nga përshpejtimi i përgjigjes normale të shërimit të indit të dëmtuar që rezulton në një proces anormal të fibrogjenezës (prodhim dhe depozitim i indit lidhor). Fibroza përparon me ritme të ndryshueshme në varësi të shkaktit të sëmundjes së mëlçisë, faktorëve mjedisorë dhe bujtës (31,32).

Cirroza është një fazë e avancuar e fibrozës së mëlçisë që shoqërohet me distorcion të vaskularizimit hepatic. Ajo çon në shunte të furnizimit portal dhe arterial të gjakut direkt në venat centrale duke kompromentuar shkëmbimin midis sinusoideve hepaticke dhe parenkimës hepaticke (hepatociteve). Sinusoidet hepaticke janë të veshura nga endoteli i fenestruar i cili mbështetet në një shtresë indi lidhor të përshkrueshëm (hapësira Disse) e cila pëmban qeliza stelate hepaticke dhe mononukleare. Ana tjetër e hapësirës Disse është e kufizuar nga hepatocitet të cilat janë përgjegjëse për shumicën e funksioneve hepaticke. Në cirrozë, hapësira Disse është e mbushur me ind të dëmtuar dhe fenestrimet endoteliale zhduken, një proces që quhet kapilarizimi sinusoidal (33).

Histologjikisht, cirroza karakterizohet nga septa fibroze të vaskularizuara që lidhin traktin portal me venat centrale, duke çuar në formimin e ishujve hepatic që janë të rrethuar me septa fibrotike dhe janë pa venë centrale. Pasoja më e rëndësishme klinike e cirrozës është funksioni i dëmtuar i hepatociteve, një rritje të rezistencës hepaticke (hipertensioni portal) dhe zhvillimi i karcinomës hepatoqelizore (HCC).

Anomalitë e qarkullimit të përgjithshëm në cirrozë (vazodilatacioni splanknik, vazokonstriksioni dhe hypoperfuzioni renal, retensioni i ujit dhe Na, rritja e hedhjes kardiake) janë të lidhura ngushtësisht me alterimet e qarkullimit hepatic dhe për rrjedhojë në hipertensionin portal. Cirroza dhe distorcioni vaskular që e shoqëron janë konsideruar si të parikthyeshme por të dhënat e fundit sugjerojnë që regresioni në cirrozë mund të jetë i mundur (34,35).

4.2 FIZPATHOLOGJIA E CIRROZËS SË DEKOMPENSUAR

Kalimi nga cirroza e kompensuar asimptomatike në cirrozë të dekompenzuar ndodh në një shkallë prej rreth 5% deri në 7% në vit (36.) Pasi ka ndodhur dekompensimi, cirroza kthehet në një sëmundje sistemike, shoqëruar me insuficiencë multiorganore (37). Në këtë fazë, pacientët bëhen shumë të ndjeshëm ndaj infeksioneve bakteriale për shkak të dëmtimit të sistemit imunitar lidhur kjo me kompleksitetin e cirrozës, përfshirë ktu imunitetin e lindur dhe të fituar (38).

Nga ana tjetër, pacientët me infeksione bakteriale janë të rriskuar nga sëmundje shoqëruese deri në Insuficiencë hepaticke akute dhe vdekshmëri të lartë (38,39.) Për shkak të këtyre ngjarjeve, dekompensimi përfaqëson një pasqyrë prognostike, pasi mbijetesa mesatare bie nga më shumë se 12 vjet për cirrozën e kompensuar deri në rreth dy vjet për cirrozën e dekompenzuar (36).

Për dekada të tëra manifestimet klinike të cirrozës së dekompenzuar janë parë si pasojë e çrregullimit të hemodinamikës. Sindromi i qarkullimit hiperdinamik, që karakterizohet nga vasodilatacioni arterial periferik që ndodh kryesisht në zonën splanike të qarkullimit. Një shtrirje e tillë e vazodilatacionit rrezikon volemënë e efekshtme, dhe çon në hipoperfuzion të organeve periferike, nga te cilat veshka është më e prekura (40). Reduktimi i volemisë së efektshme sjell aktivizimin e mekanizmit vazokonstriktor dhe mekanizmat mbajtës të ujit dhe natriumit, të tilla si renin-angiotensin- aldosteroni (RAAS), sistemin nervor simpatik dhe

sekretimin e argininë-vazopresin. Kjo shpjegon disa nga tiparet kardinale të cirrozës së dekompensuar, të tilla si mbajtja renale e natriumit dhe ujit që çon në formimin e ascitit dhe HRS. Dekompensimi akut në cirrozë karakterizohet nga zhvillimi i komplikacioneve të lidhura me cirrozën, si asciti, encefalopatia hepatike, hemoragjia nga varicet e ezofagut ose infeksionet bakteriale, dhe 30 % e pacientëve progresojnë në insuficiencën multiorganore ekstrahepatike dhe insuficiencën akute mbi kronike (ACLF). Mortaliteti pas 90 ditëve mbetet i lartë, duke variuar nga 14% të dekompensimit akut në 50% në ACLF, kryesisht terapitë janë të pamjaftueshme për të ndaluar avancimin e sëmundjes.

Dekompensimi akut shkaktohet shpesh nga precipitimi i cili përshpejton një kaskadë të proceseve patomekanistike, por afërsisht në 40% të rasteve ngjarja iniciuese nuk mund të identifikohet(41,42.)

Observimet tradicionale fizpatologjike evidentojnë hipertensionin portal me vazodilatacionin splanknik dhe sistematik dhe qarkullimin hiperdinamik si mekanizëm qëndror në procesin e dekompensimit akut hepatic (43). Megjithatë, gjetjet më të fundit përfshijnë konceptin që inflamacioni sistematik, disfunksioni mitokondrial, disfunksioni i stresit oksidativ dhe ndryshimet metabolike mund të çojnë në dëmtim të indit hepatic dhe insuficiencë organore ekstrahepatike (44,45).

4.1.1 Roli i Hipertensionit Portal

Hipertensionin portal është një pasojë e cirrozës dhe një përcaktues i rëndësishëm i dekursit të sëmundjes dhe prognozës së saj(46,48) Në stadin e kompensuar, zhvillimi i hipertensionit portal klinikisht të evidentueshëm, përcaktuar nga gradienti i presionit venoz hepatic (HVPG) prej të paktën 10mmHg, i cili lajmëron formimin e kolateraleve porto-sistematike dhe formimin e variçeve ezofageale dhe gastrike, çka shoqërohet me një prognozë të keqe (49).

Cirroza e dekompensuar është e lidhur me zhvillimin e komplikacioneve, si asciti, hemoragjia nga varicet e ezofagut dhe encefalopatia hepatike, të cilat kërkojnë HVPG të rritur mbi 10mmHg (47). Korigjimi i hipertensionit portal ka një implikim pozitiv në dekursin dhe prognozën e sëmundjes duke provuar kështu terapinë racionale që reduktojnë presionin portal(50).

Hipertensionin portal mund të jetë pasojë e rritjes së fluksit, rritjes së rezistencës vaskulare, ose kombinimi i të dyjave.

Në kushte fiziologjike, volumi portal kalon përmes heparit. Rritja e rezistencës përgjatë ecurisë së sëmundjes kronike të mëlçisë gjithmonë inicion hipertensionin portal në cirrozë e cila çon në kongestionin prehepatik. Rritja e fluksit të gjakut përmes sistemit portal mund të kontribuojë në mënyrë sinjifikative tek hipertensionin portal vetëm kur rritja e HVPG është e lidhur me faktorin vaskular endothelial të rritjes (VEGF) i cili nxit angiogjenezën dhe formimin e sistemit kolateral portal, i cili inicion rritjen e fluksit portal të gjakut. Në cirrozën e dekompensuar, sasia e gjakut të kolateralizuar mund të kalojë 90% të totalit të gjakut portal venoz (51).

Sinusoidat hepatike janë ndjeshëm të reduktuara në cirrozë për shkak të alterimeve fizpatologjike të cilat mund të ndahen në dy komponente kryesor.

I pari është një komponent struktural që përfshin depozitimin e kolagenit, fibrozën e mëlçisë dhe formimin e noduleve, të cilat shtrembërojnë anatominë vaskulare të heparit dhe rrisin ngurtësimin e heparit, kapilarizimin e sinusoidave dhe okluzionin vaskular.

Okluzioni vaskular mund të agravohet nga mikrotrombet, të cilat mund prevenohen nga heparina dhe antikoagulantë të tjerë (52).

Një karakteristike e njohur prej kohësh në cirrozën hepatike të avancuar është qarkullimi hiperdinamik, një anormalitet i sistemit hemodinamik i shkaktuar nga vazodilatacioni periferik arterial (53).

Manifestimet klinike të cirrozës së dekompensuar janë vlerësuar si pasojë e çrregullimit të hemodinamikës.

Sindromi i qarkullimit hiperdinamik, që karakterizohet nga vasodilatacioni arterial periferik që ndodh kryesisht në zonën splankike të qarkullimit. Një shtrirje e tillë e vazodilatacionit rrezikon volemënë e efekshtme dhe çon në hipoperfusion të organeve periferike, nga të cilat veshka është më e prekura (53).

Reduktimi i volemisë së efektshme sjell aktivizimin e mekanizmit vazokonstriktor dhe mekanizmat mbajtës të ujit dhe natriumit, të tilla si renin-angiotensin-aldosteroni (RAAS), sistemin nervor simpatik dhe sekretimin e argininë-vazopresinë.

Kjo shpjegon disa nga tiparet kardinale të cirrozës së dekompensuar, të tilla si mbajtja renale e natriumit dhe ujit që çon në formimin e ascitit dhe HRS.

Megjithëse mekanizmat molekularë përgjegjës për vasodilacionin arterial, karakterizohen nga një prodhim endotelial i rritur i substancave vasodilatuese, të tilla si oksidi nitrik, monoksidi i karbonit, prostaciklinat dhe endokanabinoidët, 11 shkaqet kryesore të këtyre anomalive ishin deri diku të paqartë derisa u bë e qartë se pacientët me cirrozë të avancuar paraqesin një gjendje të inflamacionit kronik, siç dëshmohet nga nivelet në rritje të qarkullimit të citokinave pro-inflamatore dhe kemiokinave (54). Kjo mund të shkaktohet nga përhapja sistemike e baktereve dhe produkteve bakteriale, të quajtur modele molekularë të lidhura me patogjenin (PAMP) si rezultat i një translokacioni bakterial anormal (BT). Ndryshimet në mikrobiomë dhe rritjen e përshkueshmërisë intestinale janë shkaktarë për këtë fenomen.




Figura 5. Paraqitje skematike e mekanizimit të formimit të Hipertensionit portal në Cirrozën Hepatike të dekompenruar.

5 KOMPLIKACIONET NË CIRROZËN HEPATIKE

Historia natyrore e cirrozës karakterizohet nga një ecuri e heshtur, asimptomatike derisa presioni portal në rritje dhe përkeqësimi i funksionit të mëlçisë arrijnë të prodhojnë një fenotip klinik tipik të sëmundjes. Në fazën asimptomatike të sëmundjes, e njohur si cirroza e kompensuar, pacientët mund të kenë një cilësi të mirë të jetës, dhe sëmundja mund të përparojë pa u zbuluar për disa vite. Dekompensimi karakterizohet nga zhvillimi i shenjave klinike të dukshme, nga të cilat më të shpeshtat janë Asciti, Hemorragjia G-I, Encefalopatia dhe Ikteri. Pas shfaqjes së parë të ndonjëres prej këtyre, sëmundja zakonisht përparon më shpejt në drejtim të vdekjes ose transplantit të mëlçisë. Kjo fazë e sëmundjes është përcaktuar si "Cirroza e dekompenruar".

5.1 ASCITI

Asciti është një grumbullim patolojik i likidit në kavitetin peritoneal zakonisht i vërejtur në cirrozën hepatike. Shkaqet e tij janë multifaktoriale, por në princip përfshin volumin sinjifikant dhe disrregullimin hormonal në instalimin e hipertensionit portal.

Diagnoza e ascitit në pacientët cirrotik vendoset duke u bazuar në shenjat klinike, laboratorike, dhe përfundimisht e konfirmuar nga egzaminimi fizik, imazheria dhe procedura e paracentezës. Trajtimi i ascitit përfshin kufizimin e natriumit në dietë, terapinë farmakologjike dhe paracentezat terapeutike dhe në raste të veçanta shuntin transjugular intrahepatik portosistemik (TIPS). Asciti është i shoqëruar me komplikacione të shumta duke përfshirë peritonitin bakterial spontan, hepato-hidrotoraxin dhe sindromin hepatorenal (56).

Asciti është shkak më i zakonshëm i dekompensimit në cirrozë, pasi shfaqet në rreth 5% deri në 10% të pacientëve me cirrozë të kompensuar në vit (57).

Mekanizmi i formimit të ascitit është retensioni renal i natriumit për shkak të aktivizimit të sistemeve të mbajtjes së natriumit, si sistemi renin-angiotensin-aldosterone (RAAS) dhe sistemi nervor simpatik. Reduktimi i volemisë efektive që vjen si rezultat i vazodilacionit splankik është një përcaktues kryesor i këtyre ndryshimeve, por dhe anomalitë e funksionit të veshkave të shkaktuara nga inflamacioni sistemik gjithashtu luajnë një rol, veçanërisht në fazat më të përparuara të cirrozës (58).

Grumbullimi i likidit ascitik në cirrozë rezulton nga një numër faktorësh gjerësisht të përcaktuar si çrregullimi hormonal dhe i citokinave të lidhura me volumin e rritur në sistemin portal.(59) Manifestimi i ascitit është një shenjë e rëndësishme në progresin e cirrozës : 1) është shkak më i shpeshtë për hospitalizim, 2) parashikon rritjen e mortalitetit për një periudhë 1 vjeçare dhe 3) funksionon si një markues risku për transplantin e heparit (59, 60,61).

Asciti në cirrozën hepatike është etiologjia më e shpeshtë e ascitit në përgjithësi, i cili përfshin rreth 85% të të gjithë rasteve (59,60).

Shkaqet e tjera të ascitit (jo-cirrotik) mund të jenë gjerësisht të përcaktuar si origjinë pre-ose post-hepatike.

Shkaqet pre-hepatike mund të përfshijnë : trombozën e venës porta, limfoma, obstruksioni i zorrës, perforacioni, peritoniti tuberkular, ose malinje me diseminim peritoneal.

Shkaqet post hepatike përfshijnë insuficiencën kardiake kongjestive ose insuficiencën kardiake të lidhur me hipertensionin pulmonar, perikarditi kontriktiv, sindromi Bud- Chiari (59,60).

Patogjeneza e ascitit mbetet e pasqaruar plotësisht dhe vazhdon të evoluojë. Një teori hibride së fundmi prevalon ku ka bashkuar teoritë e mëparshme të overflow dhe underflow (59,60,62).

Një paraqitje e shkurtër e këtyre teorive sugjeron si më poshtë:

1) dëmtim i vazhdueshëm mbi hepar si kombinimi i faktorëve egzogjen (hepatiti kronik viral ose alkolik ose steatohepatiti joalkolik NASH,

2) faktorët gjenetik

3) vazhdimi i mikroproçeseve të inflamacionit, nekroza dhe depozitimi/ rigjenerimi i kolagjenit, të gjithë këta mekanizma çojnë në transformimin e mëlçisë nga një sistem me rezistencë të ulur në një sistem me rezistencë të lartë si për shembull një spektër i fibrozës me disfunkcion të muskujve të lëmuar (63).

Ky proces i vazhdueshëm mund të çojë në rritjen e presionit në venën porta. Vena porta është normalisht 8 cm gjatësi dhe zakonisht <13 mm diametër. Hipertensioni portal përcaktohet në vlerën 6 mmHg dhe më sipër, ndërsa asciti formohet zakonisht në vlerat 8 mmHg e lart. Vihet re se dekompensimi i mëtejshëm klinik në formimin e variçeve (10 mmHg), rritja e rriskut të hemoragjisë nga variçet (12 mmHg) dhe rrisku për rihemoragji nga variçet (20 mmHg), korrelojnë me rritjen e hipertensionit portal (64,65).

Me instalimin e hipertensionit portal, kthimi prapa dhe staza e substancave vazodilatatore si oksidi nitrik, fillon të akumulohet (66). Kjo shkakton ndër të tjera vazodilatacion splanknik me hipoperfuzion të sistemit renal e cila nga ana tjetër nxit sistemin renin-angiotenzin-aldosteron duke çuar në retension agresiv të likidit (67,69.)

Shkurtimisht, renina sekretohet nga aparati jukstagromerular pranë nefronit proksimal në përgjigje të ndryshimeve të presionit vaskular, ndryshimeve të Na serik, dhe nga aktivizimi i sistemit nervor simpatik (66.)

Ai nga ana tjetër do të konvertojë angiotensinogjenin (i prodhuar në hepar) në angiotenzin 1, i cili më vonë konvertohet në angiotenzinë 2 nga enzima konvertuese e angiotenzinës (66,68).

5.1.1 Manifestimet klinike të ascitit

Prezantimet klinike të ascitit variojnë: mund të formohet ngadalë siç ndodh në sëmundjet kronike të heparit, ose i menjëhershëm si në obstrukcionin mekanik të venave të mëdha, tromboza e venës hepatike ose venës porta, kompresioni i vena cava inferior nga trauma (hematoma) ose infeksioni, ose insuficienca akute hepatike.

Asciti mund të jetë i padhimbshëm, dhe nëse është i shoqëruar me dhimbje abdominale mundet thjesht të japi diskomfort abdominal nga distendimi mekanik, ose infektimi i likidit ascitik si në rastin e peritonitit bakterial spontan, ose në karcinomën hepatoqelizore (67,70).

Kështu që ndërsa asciti përfaqëson një progresion natyral të cirrozës, shfaqja e tij duhet të nxisi një investigim të kujdesshëm për shkaqe dhe komplikacione të tjera (64).

Asciti mund të klasifikohet në 3 grada të severitetit: grada 1, kur është i diagnostikuar me echo abdominale dhe ka rreth 100 ml likid në abdomen, grada 2, ku sasia e likidit është rreth 1000 ml, i cili mund të zbulohet nëpërmjet egzaminimit fizik përmes shenjave si flanket e varura, vala e likidit, grada 3, manifestohet si një abdomen i distenduar me sasi të mëdha asciti, e cila mund të japi tek pacientët një ndjenjë të diskomfortit të shprehur dhe mund të përshkruhet si asciti i distenduar (64,71,72).

5.1.2 Paracenteza dhe testet laboratorike:

Si çdo procedurë, paracenteza diagnostike duhet të ketë parasysh gjendjen e koagulimit, dhe në fakt në cirrotikët me ascit koagulabiliteti i tyre është i alteruar (73.) Sigurisht, është një deficiet në prodhimin dhe/ose aktivitetin e protrombinës, por ky parametër nuk mat të gjithë faktorët e koagulimit. Idea se këta pacientë janë të antikoagular nuk është e vërtetë, dhe këta të sëmurë mund të jenë në rrezik real për sëmundje tromboembolie (74).

Duke marrë parasysh këtë sfond problematik, duhen parë të dhënat empirike megjithëse të kufizuara, sugjerojnë që paracenteza është toleruar mirë në pacientët me trombocite nën 20000 qeliza/mm³ dhe INR deri në 8.7 (75,76).

Komplikacionet e hematomës së paretit abdominal kërkojnë transfuzion gjaku. Një kundërindikacion i rëndësishëm është koagulimi intravaskular i diseminuar (64). Evidenca për kërkesë të transfuzioneve të produkteve të gjakut, nga shërbime johepatologjike, për të arritur arbitrarisht limitet e INR < 1.5 ose trombocitet > 50000 është e pabazuar, shpenzim i resurseve dhe kohës.

Paracenteza diagnostike, ndryshe nga ajo terapeutike, kërkon afërsisht 30-50 ml ascit dhe është e detyrueshme në të gjitha rastet e ascitit për herë të parë ose ascitit që ndodh në individë me alterim të gjendjes së përgjithshme që përfshin temperaturë, dhimbjen abdominale, përkeqsimi i encefalopatisë hepatike dhe ndonjë shenjë ose simptomë të infeksionit të gjeneralizuar. Paracenteza mund të diagnostikojë peritonitin bakterial spontan (SBP) në pacientët e hospitalizuar jo vetëm për sëmundje të heparit (72,77).

Analiza e likidit ascitik duhet të përfshijë në të gjitha rastet numërimin e qelizave, albuminën dhe proteinën totale si dhe kulturën e likidit (77).

Studime të tjera varen nga situata klinike ose shfaqja e ascitit mund të përfshijë laktat hidrogjenazën (LDH), citologji, amilazë, glukozë, proteinën totale dhe triglyceride (64).

Likidi ascitik që nuk është neutrofitrik as i infektuar duhet të jetë me ngjyrë të verdhë të kthjellët dhe transparent. Në ascitin normal numri i neutrofileve duhet të jetë < 250 qeliza/mm³, ku neutrofilet janë zakonisht prezent si një përqindje e qelizave të bardha të gjakut. Një keqinterpretim i zakonshëm është të lexosh këtë përqindje si numri absolut i neutrofileve, duke rrezikuar diagnozën e SBP. Një rritje e leukociteve është sigurisht indikative për inflamacion dhe zakonisht por jo përfundimisht për infeksionin në SBP (64,77).

Prania e neutrofileve në likid mbi 250 qeliza / mm³ nënkupton Peritonit bakterial spontan (78). Një përqendrim total i proteinave <1.5 g / dl konsiderohet në përgjithësi si një faktor rreziku për SBP. Përlllogaritja e gradientit të albuminës (SAAG) serum-ascit mund të jetë i dobishëm kur shkak i ascitit nuk është menjëherë i dukshëm, pasi SAAG ≥1.1 g / dl tregon se hipertensioni portal është i përfshirë në formimin e ascitit me një saktësi prej rreth 97% (79).

Testet e tjera, të tilla si amilaza, citologjia ose kultura për mykobakteret duhet të udhëhiqen nga diagnoza klinike.

Matja e kolesterolit ascitik së bashku me citologjinë dhe përcaktimi i antigjenit carcinoembryonic (CEA) në mostrat ku përqendrimi i kolesterolit tejkalon 45 mg / dl duket të jetë një metodë me kosto efektive për diagnozën diferenciale midis asciteve të lidhura me shkaqe malinje dhe jo-malinje.(80) Nëse kemi një pamje të ashtuquajtur “milky ascites” sugjeron për një vlerë të lartë të triglycerideve në ascit mbi 100-200mg/dl (asciti kiloz nga dëmtimi i duktuseve limfatik (78).

Shfaqja e ascitit në pacientët cirrotikë është e shoqëruar me një prognozë të varfër, pasi vdekshmëria një dhe dy vjeçare rezulton në 40 dhe 50%, respektivisht. Për këtë arsye pacientët me

ascit në përgjithësi duhet të referohen për transplant hepatic. Hiponatremia, presioni i ulët arterial, norma e filtrimit glomerular (GFR) dhe sekretimi i ulët renal i natriumit janë parashikues të pavarur të vdekshmërisë në cirrozën me ascit (81), pasi këto parametra nuk përfshihen në rezultatin Child-Pugh dhe vetëm kreatinina në serum (SCr) e cila mbivlerëson GFR në cirrozë, është përfshirë në modelin end-stage të sëmundjes së mëlçisë (MELD), modelet më të përdorura prognostike mund të nënvlerësojnë rrezikun e vdekshmërisë në pacientët me ascit (82).

Për këtë arsye janë bërë modifikimet e rezultatit të MELD, të tilla si rezultatet e MELD-Na dhe MELD-Ascit të cilat vetëm pjesërisht kanë bërë tejkalimin e këtij kufizimi (83).

Pra, pacientët me ascit nuk mund të marrin përparësi adekuate në listat e transplantëve, prandaj nevojiten metoda të përmirësuara për të vlerësuar prognozën në këta pacientë.

5.1.3 *Trajtimi i ascitit të pakomplikuar:*

Ascit i pa komplikuar quhet kur është i painfektuar, jorefraktar dhe i palidhur me Sindromin hepatorenal (SHR).

Asciti në sasi të pakët (grada 1) : Nuk ka të dhëna për evolucionin e ascitit të Grades 1 as nuk dihet nëse trajtimi i tij e modifikon historinë e tij natyrore.

Asciti në sasi mesatare (grada 2) : Pacientët të cilët zhvillojnë ascit të Gradës 2 nuk kërkojnë hospitalizim, përveçse nëse janë të pranishme komplikacione të tjera. Ata kanë një ekuilibër pozitiv të natriumit, i cili mund të korrigjohet duke ulur marrjen e natriumit nëpërmjet dietës dhe duke rritur sekretimin renal të natriumit me diuretikë (87).

5.1.4 *Kufizimi i Na:*

Kufizimi profilaktik i kripës në dietën ushqimore në pacientë që nuk kanë pasur asnjëherë ascit nuk mbështetet nga studimet e shumta. Kufizimi i natriumit të dietës mund të çojë në zhdukjen e ascitit në rreth 10% të pacientëve, sidomos në ata me episodin e parë të ascitit (85). Një avantazh i qartë nga përdorimi i dietave të ulëta në natrium të shoqëruar me diuretikë nuk ka rezultuar nga provat klinike duke krahasuar regjimet e ndryshme dietetike (85,86). Kufizimi ekstrem i natriumit favorizon zhvillimin e hiponatremisë të shkaktuar nga diuretikët dhe insuficiencia renale (87). Për më tepër, edhe kufizimi i moderuar i natriumit kur nuk shoqërohet me një shpjegim të saktë dhe adekuat, shpesh lidhet me marrjen e kalorive të reduktuara, dhe mund të pengojë marrjen e vlerave të duhura ushqimore (88). Rekomandimi aktual është se natriumi në dietë duhet të kufizohet vetëm mesatarisht (80-120 mmol / ditë), kryesisht për të shmangur marrjen e tepërt të kripës..

5.1.5. *Diuretikët*

As diuretikët dhe as paracentezat svotuese masive nuk janë të lidhura me një përfitim në mbijetesë, sepse ato veprojnë në të njëjtin drejtim të kaskadës fiziopatologjike, duke qënë terapi simptomatike. Balanca negative e lëngjeve e shkaktuar nga diuretikët nuk duhet të çojë në një humbje të peshës trupore që tejkalon 0.5 kg / ditë në pacientë pa edema periferike dhe 1 kg / ditë në pacientë me prani të edemave periferike për të shmangur reduktimin e volumit plazmatik

qarkullues, që përfundimisht çon në insuficiencë renale dhe hiponatraemi (89), pasi hiperaldosteronizmi dytësor luan një rol kryesor në mbajtjen e natriumit serik në pacientët me cirrozë (90,91). Diuretikët anti-mineralokortikoide (spironolaktoni, kanrenoni ose K-kanrenoate) përfaqësojnë bazën në trajtimin mjekësor të ascitit (91). Katërqind mg në ditë përfaqëson dozën maksimale që zakonisht rekomandohet (92,93). Mekanizmi i veprimit të anti-mineralokortikoideve shpjegon efektin e tyre të ngadaltë. Në fakt, shtegu i aktivizuar i aldosteronit, që përfshin ndërveprimin me një receptor citozolik dhe, më pas, një receptor bërthamor, duhet të përdoret para se të lindë efekti i tyre natriuretik. Prandaj, doza e këtyre barnave nuk duhet të rritet më herët se 72 orë.

Amiloridi, një diuretik që vepron në tubulat kolektore, është më pak efektiv se antimineralokortikoidët dhe duhet të përdoret vetëm në pacientët të cilët zhvillojnë efekte anësore të rënda me antagonistët e aldosteronit (94).

Reabsorbimi tubular proksimal i Na nxit retensionin renal të natriumit përmes mekanizmave të ndryshëm, siç është rritja e prodhimit të angiotensin II, hiperaktiviteti simpatiko-adrenergjik dhe perfuzion të ulur të veshkave (90).

Nëse reabsorbimi tubular proksimal Na bëhet mbizotërues në pacientët me ascit që persiston në kohë, duhet të fillojë përdorimi i diuretikëve të ansës (95,96). Megjithatë, ato duhet të kombinohen, por jo të zëvendësojnë anti-mineralokortikoidet.

Në të vërtetë, pavarësisht nga aktiviteti i tyre i fuqishëm, efekti natriuretik i diuretikëve të ansës mund të eliminohet krejtësisht nga hiperaldosteronizmi i pamposhtur.(97) Nëse trajtimi me diuretik duhet të fillohet vetëm me anti-mineralokortikoidet ose duhet të përfshijë edhe një diuretik të ansës, ky është një debat që ka kohë që vazhdon.

Dy studime kanë adresuar këtë çështje duke dhënë rezultate të dukshme konfliktuale për shkak të dallimeve në popullatën e pacientëve(98,99).

Në të dy studimet, u studiuan efektet e një regjimi diuretik fillimisht të përbërë nga spironolaktoni ose K-kanzoate dhe me dozat rritëse graduale (nga 100/200 në 400 mg / ditë), me furosemidin e shtuar në pacientët që nuk reagojnë, të cilat u krahasuan me ato të kombinimit të anti-mineralokortikoidëve me furosemid (nga 40 në 160 mg / ditë) që nga fillimi i trajtimit.

Kështu, pacientët me ascit për herë të parë mund të trajtohen vetëm me antimineralokortikoidë, pasi ata ka gjasa të zhvillojnë një përgjigje të kënaqshme me disa efekte anësore. Pacientët me ascit të gjatë të përhershëm duhet të marrin terapi të kombinuar, e cila ka gjasa të shkurtojë kohën për të arritur natriurezën dhe ul incidencën e hiperkalemisë.

Pas mobilizimit të ascitit, diuretikët duhet të jenë në dozat më të ulëta në gjendje të mbajnë pacientët me ascit minimal ose pa ascit fare, për të minimizuar efektet anësore. Kurdoherë që është e mundur, duhet të realizohet një trajtim etiologjik i cirozës themelore, pasi kjo lehtëson kontrollin e ascitit në shume raste.

5.1.5.1. Komplikacionet e terapisë me diuretikë.

Gjendja hemodinamike e pacientëve me cirrozë dhe ascit i bën ata të ndjeshëm ndaj reduktimeve të shpejta të volumit të likidit ekstracelular, të cilat kryesisht ndodhin me diuretikët e ansës (100). Kështu, insuficienca renale është komplikacioni më i shpeshtë që shfaqet (101) ashtu siç është dhe encefalopatia hepatike, gjithashtu e favorizuar nga rritja e prodhimit renal të amoniakut. Diuretikët e ansës mund të çojnë gjithashtu në pakesim të kaliumit dhe magnezit. Hiponatremia është një tjetër efekt i zakonshëm i shoqëruar me përdorimin e diuretikeve në cirrozë. Ajo kryesisht, por jo ekskluzivisht, ndodh me diuretikët e ansës, pasi ato pengojnë transportuesin Na-K-Cl. Tkurrja e volumit të plazmës mund të përmirësojë gjithashtu lirim të argininë-vazopresinës. Kështu, hiponatraemia gjithashtu mund të pasojë me administrimin anti-mineralokortikoid, edhe pse rrallë.

Shumica e ekspertëve bien dakord të paktën nderprejen e përkohshme të diuretikëve kur përqendrimi i natriumit në serum ulet nën 120-125 mmol/L.

Hiperkalemia, sidomos në pacientët me perfuzion renal të reduktuar dhe gjinekomastia e dhimbshme janë efektet më të zakonshme anësore të nxitura nga anti-mineralokortikoidet. Dhimbjet e muskujve mund të dëmtojnë cilësinë e jetës në pacientët që marrin diuretikë.

Grada 3 ose asciti në sasi të konsiderueshme: Trajtimi i preferuar për menaxhimin e pacientëve me ascit të Grades 3 përfaqësohet nga paracentezat masive svotuese.

Paracenteza duhet të kryhet nën kushte strikte sterile duke përdorur materiale sterile të disponueshme. Procedura është e lidhur me një rrezik shumë të ulët të komplikimeve lokale, veçanërisht hemorragjisë (102,103). Edhe në pacientë me raporte të normalizuara ndërkombëtare të (INR) > 1,5 dhe numër të trombociteve <50,000 /(104), shfaqja e hemorragjisë ndodhi në dy raste nga 142 paracenteza (102). Pra, nuk ka të dhëna që mbështesin përdorimin profilaktik të plazmës së freskët të ngrirë dhe të masave trombocitare, edhe pse këto janë të përdorura në shumë qendra kur niveli i protrombines është nën 40% dhe numërimi i trombociteve <40,000 (104). Paracenteza masive svotuese duhet të shmanget në prani të koagulimit intravaskular të diseminuar. Janë raportuar kundërindikacione të tjera ndaj LVP (large volume paracentesis).

5.1.6 Kundërindikacionet e paracentezës:

1. Pacienti jobashkpunues
2. Infektim i paretit abdominal në vendin ku do kryhet paracenteza
3. Çrregullime të koagulimit në shtatzani (fibrinolizë, KID)
4. Distendim i theksuar i intestinit

Heqja e vëllimeve të mëdha të likidit ascitik është potencialisht e lidhur me një pakësim të mëtejshëm të volumit të gjakut qarkullues efektiv, një gjendje e njohur si mosfunksionimi i qarkullimit të gjakut pas paracentezës (PPCD) (105.)

Shfaqjet klinike të PPCD janë insuficenca renale, hiponatremia nga hemodiluimi, encefalopatia hepatike dhe zvogëlimi i mbijetesës.

Shtimi i vëllimit të plazmës duhet të kryhet në përfundimin e LVP për të parandaluar këtë ndërlikim. Mbushësit artificialë të plazmës, të tilla si dekstran-70 (8 g / L ascitin e hequr) ose polygeline (150 ml / L), (106) ose perfuzione saline (170 ml / L),(107) tregojnë vetëm një efikasitet të ngjashëm me 20% albumin g / L) kur hiqen më pak se 5 L ascit (106). Megjithatë, polygeline nuk është përdorur më në shumë vende për shkak të rrezikut potencial të transmetimit të prioneve dhe dekstrani mbart rrezikun e reaksioneve të rënda alergjike dhe insuficencës renale.

Një meta-analizë e testeve të randomizuara tregoi se albumina është shumë më e mirë se çdo mbushës tjetër i plazmës ose vazokonstriktor jo vetëm në parandalimin e PPCD, por edhe në pasojat e tij klinike, të tilla si hiponatriemia dhe vdekshmëria (108).

Për më tepër, infuzionet me albumin pas LVP duket të jetë më kosto - efektive sesa një mbushës më i lirë i vëllimit të plazmës, siç është poligelina, për shkak të numrit më të ulët të komplikimeve të mëlçisë dhe shpenzimeve spitalore për një periudhë 30-ditore (109). Paracentezat svotuese masive kombinuar me infuzione të albuminës në pacientët me ascit të Grades 3 janë më efektive dhe më të sigurta sesa diuretikët (110,111).

Megjithatë, LVP nuk modifikon anomalitë themelore patofiziologjike që çojnë në formimin e ascitit. Kështu, pacientët e trajtuar me LVP kërkojnë terapi diuretike për të parandaluar ri-akumulimin e ascitit (112).

5.1.7 Asciti Refraktar

Asciti refraktar përcaktohet si ascit që nuk mund të eliminohet ose prani e likidit që përsëritet në menyrë të herë pas hershme, sasia e të cilit (pra pas Paracentezave masive svotuese) nuk mund të pakësohet në mënyrë të kënaqshme nga terapia mjekësore(92,93) Refraktariteti i ascitit lidhet me një prognozë të dobët, dhe me një mbijetesë mesatare prej rreth gjashtë muaj.(114) Prandaj, nëse një pacient me ascit refraktar ende nuk është konsideruar për Transplant hepatic, ai duhet referuar menjëherë drejt një qendre transplantimi të mëlçisë.

Menaxhimi i ascitit refraktar

Paracentezat svotuese masive: Paracenteza svotuese masive (LVP) është një trajtim efektiv dhe i sigurt i ascitit refraktar, i cili duhet të shoqërohet me administrimin e albuminës për të parandaluar PPCD (92,113).

Diuretikët në pacientët me ascit refraktar.

Sapo të jetë konstatuar refraktariteti i ascitit, diuretikët duhet të ndërpriten. Vetëm kur sekretimi i renal i Na tejkalon 30 mmol / ditë, mund të konsiderohet mbajtja e terapisë diuretike, kur është e tolerueshme (92.)

5.1.8 Shunti transjugular intrahepatik portosistemik (TIPS):

Shunti transjugular intrahepatik portosistemik (TIPS) ul presionin në sistemin portal duke by-pasuar një degë portale intrahepatike me një nga venat hepatike. Aplikimi i saj thekson vasodilacionin periferik arterial por në një periudhë të shkurtër. Megjithatë, brenda 4-6 javëve rezultati i saj është një përmirësim në vëllimin efektiv qarkullues dhe funksionin e veshkave, duke çuar përfundimisht në rritjen e ekstremit renal të natriumit (115,117). Natriureza e nxitur nga TIPS-i mund të vonohet nga mosha e avancuar dhe vlera e pakesuar GFR pre-TIPS (116) si dhe të parandalohen nga sëmundja preekzistuese të veshkave (118). TIPS mund të ushtrojë gjithashtu efekte të dobishme për bilancin e azotit, në nutricion dhe cilësinë e jetës (119,120).

Një ndërlikim i madh pas aplikimit të TIPS është zhvillimi i encefalopatisë hepatike, e cila mund të ndodhë deri në 50% të pacientëve (121,122).

Incidenca e këtij komplikacioni mund të reduktohet ndjeshëm në rreth 18% me përdorimin e politetrafluoroetilenit (PTFE) i cili mbulon graftet e stentit prej 8 mm, një rezultat i konfirmuar nga një studim i kohëve të fundit.

5.1.9 Trajtimi Medikamentoz:

Janë propozuar terapitë që synojnë përmirësimin e funksionit qarkullues të gjakut dhe të veshkave.

5.1.9.1 Midodrina agoniste α 1-adrenergjike

Ka treguar të përmirësojë hemodinamikën sistemike dhe renale tek pacientët me cirrozë dhe ascit të pakomplikuara. (123)

Në një RCT të vogël u krahasua shtimi i midodrinës (7.5 mg tid) në trajtimin diuretik kundrejt vetëm trajtimit me diuretik në pacientët me ascit refraktar ose ascit recidivant për gjashtë muaj, me vetëm një efekt pozitiv transitor në kontrollin e ascitit të parë në muajin e tretë (124). Përdorimi i terlipresinës, një analog i vasopresinës me një efekt vasokonstriktor mbizotërues në fushën e qarkullimit splanchnik në pacientët me ascit refraktar është vlerësuar vetëm në studimet akute.

Në një studim (125), administrimi i terlipresinës (1 deri në 2 mg intravenoz sipas peshës trupore) vetëm rriti sekretimin renal të veshkave kur shoqërohej me faktorin ekzogjen natriuretik atrial.

Në një tjetër studim (118), 2 mg terlipresin çoi në një rritje në GFR, rrjedhjen e plazmës renale dhe sekretimin renal të Na. Megjithatë, në këtë studim u përfshinë vetëm tetë pacientë me ascit refraktar. Nëse një trajtim i zgjatur me terlipresin mund të çojë në një përmirësim klinikisht të rëndësishëm të funksionit renal dhe sekretimit të natriumit në ascitet refraktare efekti nuk është i njohur.

5.1.9.2. Alfapump.

Sistemi i pompave të automatizuara me fluks të ulët të ascitit (Alfapump) përbëhen nga një pompë e programuar me baterinë e lokalizuar subkutane. Ajo lidhet me katetere që transferojnë ascitin nga kaviteti peritoneal në fshikëz, nga e cila eliminohet me urinë.

Pajisja ka sensorë të brendshëm që monitorojnë funksionin e pompës. Në dy studime multicentre të sigurisë dhe efikasitetit (124,125). Alfapump siguroi një reduktim të ndjeshëm të numrit dhe volumit të paracentezës në pacientët me cirrozë të avancuar dhe ascit refraktar. Megjithatë, efektet e dëmshme që lidhen drejtpërdrejt me pajisjen ndodhën në rreth një të tretën deri në gjysmën e rasteve (127). Alfapump nuk kishte efekt mbi mbijetesën dhe ishte shoqëruar me një incidencë dukshëm më të lartë të ngjarjeve serioze të padëshiruara (85.2 vs 45.2%), kryesisht të përfaqësuar nga Insuficiencia renale akute (126).

Pra, edhe pse Alfapump është efektive në zvogëlimin e nevojës për paracentezë në pacientë me ascit refraktar, efektet e saj të shpeshta anësore kërkojnë monitorim të ngushtë të pacientëve.

5.2 HIDROTORAKSI HEPATIK

Hidrotoraksi hepatic është akumulimi i likidit transudativ në hapësirën pleurale në pacientët me cirrozë të dekompenzuar, në mungesë të sëmundjes kardiake, pulmonare ose pleurale. Formimi i tij është sekondar si pasojë e defekteve të vogla diafragmatike, më shpesh të vendosura në anën e djathtë, përmes të cilave asciti lëviz në hapësirën pleurale për shkak të presionit negativ intratorakal të nxitur nga frymemarrja.

Hidrotoraxi hepatic mund të çojë në insuficiencë respiratore dhe mund të komplikohet nga infeksionet spontane bakteriale (empiema).

Prania e këtij komplikacioni shoqërohet me prognozë të dobët, pasi mbijetesa mesatare e pacientëve me hidrotorax hepatic varion nga 8-12 muaj (128,129). Në mënyrë të veçantë, markerat më të shpeshtë prognostike, të tilla si Child-Pugh dhe MELD, duket se e nënvlerësojnë një rezultat të tillë.

5.2.1 *Diagnoza e hidrotoraksit Hepatic:*

Sapo të verifikohet prania e likidit pleural, duhet të përjashtohet prania e sëmundjeve kardiopulmonare dhe pleurale primare.

Torakocenteza diagnostike kërkohet për të përjashtuar infeksionin bakterial, diagnoza e të cilit bazohet në të njëjtat kritere të përshkruara për ascitin. Përmbajtja e proteinave të likidit pleural në hidrotoraxin hepatic të pakomplikuara është e ulët dhe gradienti i albuminës së likidit pleural është më i madh se 1.1 g / dl (130).

Prania dhe shtrirja e defekteve diafragmatike mund të vlerësohen në mënyrë indirekte, nëpërmjet teknikave radioizotope ose direkt nga rezonanca magnetike ose me ultrasonografi me color Doppler (131).




Figura 6: Pamje imazherike nw grafi dhe skaner pulmoni tw hidrotoraxit hepatic

5.2.2 Trajtimi i hidrotoraksit hepatic:

Menaxhimi i linjës së parë mbështetet në trajtimin e ascitit me diuretike dhe / ose transplant hepatic siç u diskutua më herët. Megjithatë, nuk është e rrallë që likidi pleural të vazhdojë të persistojë pavarësisht trajtimit të suksesshëm të ascitit (hidrotoraxi refraktar).

Rekomandohet kryerja e torakocentezës terapeutike për të lehtësuar dispnenë. Efikasiteti i saj në hidrotoraxin hepatic refraktar është i përkohshëm dhe torakocentezat përsëritëse, rrisin rrezikun e komplikimeve të tilla si pneumotoraxi, shfaqjen e infeksionit pleural ose të indeve të buta dhe hemorragjisë (132).

Shfaqja e shpeshtë e këtyre komplikimeve dekurajon aplikimim kronik të drenimit pleural, i cili gjithashtu mund të ndiqet nga insuficensa renale nga humbja e lëngjeve

Kurdoherë që është e mundur dhe e mundshme, Transplanti hepatic paraqet opsionin më të mirë për pacientët me hidrotorax hepatic refraktar, i cili nuk duket se ndikon negativisht në rezultatin e transplantimit (134).

TIPS është përdorur në mënyrë efektive si trajtim përfundimtar ose si nje rrugë e ndërmjetme për transplantim në pacientët me hidrotorax hepatic refraktar, rezultati i të cilit eshte i lidhur me gravitetin e cirrozës themelore (133).

Pleurodezia e shkaktuar nga agjentë të ndryshëm, si talk, tetraciklin, doksiciklin, bleomicin dhe povidoni-jod, është një mundësi që mund t'u ofrohet pacientëve të cilët nuk janë kandidatë për TIPS ose Transplant hepatic.

Një meta-analizë e kohëve të fundit tregoi se pergjigja pozitive pas pleurodezisë ishte 72%. Megjithatë, niveli i komplikimeve në lidhje me këtë procedurë ishte i lartë deri në 82% (135). Së fundmi, riparimi torakoskopik me rrjetë mersileni duket të jetë efektiv në pacientët me defekte diafragmatike të përcaktuara mirë (136).

Sëmundja e mëlçisë së avancuar, siç vlerësohet nga rezultati MELD, dhe mosfunksionimi preoperativ renal duket të ndikojë negativisht në mbijetesën tre-mujore.

5.3 HYPONATREMIA

5.3.1 Përkufizimi dhe fizpatologjia

Hiponatremia është një shfaqje e zakonshme në pacientët me cirrozë të avancuar dhe përcaktohet si përqëndrimi i natriumit në serum më e ulët se 130 mmol / L (146).

Sipas udhëzimeve për hiponatreminë në popullatën e përgjithshme të pacientëve, duhet të merren parasysh një ulje e vlerave nën 135 mmol / L.

Pacientët me shfaqje të hiponatremisë kanë një prognozë të dobët, pasi ajo është e lidhur me vdekshmërinë në rritje dhe praninë e sëmundjeve shoqëruese, sidomos me shfaqjen e komplikacioneve neurologjike, (138,139) dhe mbijetesën e reduktuar pas Transplantit hepatic (145).

Përqëndrimi i Na në serum është përfshirë në rezultatin e MELD, që gjeneron një rezultat të ri (MELD-Na) që siguron parashikime më të sakta të mbijetesës sesa vetëm MELD, sidomos në pacientët me ascit dhe hiponatremi me vlera mesatare të MELD (143).

Në pacientët cirrotikë hiponatremia mund të shfaqet dhe në hipovolemi dhe në hipervolemi. Shfaqja e dytë, është më e zakonshme, dhe karakterizohet nga një shtrirje më e gjërë e volumit të lëngjeve ekstracelulare, shoqëruar me ascit dhe edemë.

Mund të ndodhë në mënyrë spontane, ose për shkak të përdorimit të tepert të likideve hipotonike (dmth., 5% dekstrozë), ose në mënyrë sekondare për shkak të komplikacioneve të cirrozës që çon në një përkeqësim të papritur të volemisë efektive.

Agjentët kryesorë janë hipersekretimi jo-osmotik i vasopresinës dhe reabsorbimi i shtuar i Na në tubulat proximale, të cilat pengojnë prodhimin e lirë të ujit dhe të dyja janë nxitur nga hipovolemia efektive. Në krahasim me hiponatreminë hipervolemike, hiponatremia hipovolemike karakterizohet nga mungesa e ascitit dhe edemave. Ajo është shkaktuar nga një bilanc i zgjatur negativ i natriumit me humbje të dukshme të lëngjeve ekstracelulare shpesh për shkak të terapisë së tepërt diuretike.




Figura 7. Mekanizmi i propozuar për zhvillimin e hyponatremisë SNS : sistemi nervor simpatik; RAAS: Sistemi Renin- Angiotensin- Aldosteron. NO: oksidi nitric; RES: sistemi retikuloendotelial; PG: Prostaglandin; AVP: Arginin vazopresin; ADH: hormoni antidiuretik.

5.3.2 Trajtimi i hyponatremisë:

Përgjithësisht mendohet se hiponatremia duhet të fillohet të trajtohet kur sasia e Na në serum është më e ulët se 130 mmol / L, megjithëse nuk ka prova të mira lidhur me nivelin e natriumit në serum në të cilin duhet të fillohet trajtimi.

Hiponatremia Hipovolemike kërkon rritjen e vëllimit plazmatik me solucione saline dhe korrigjimin e faktorit shkaktues.

Menaxhimi i hiponatremisë hipervolemike kërkon arritjen e një balanci negativ të ujit.

Kufizimi i lëngjeve jo-osmotike ndihmon në parandalimin e uljes së mëtejshme të niveleve të natriumit të serumit, por është rrallë efektiv në përmirësimin e natremisë.

Administrimi i klorurit të natriumit hipertonic tek pacientët me cirrozë të dekompenzuar mund të përmirësojë natreminë, por rrit mbingarkimin e vëllimit qarkullues dhe përkeqëson sasinë e ascitit dhe edemës.

Prandaj, korrigjimi i hiponatremisë duhet të kufizohet në hiponatreminë e rëndë simptomatike, që përcaktohet nga manifestimet e rrezikshme për jetën, si distresi kardio-respirator, somnolenca

jonormale dhe të thellë, krizat epileptike dhe koma, të cilat nuk ndodhin shpesh në pacientët me cirrozë. Për më tepër, administrimi i klorurit të natriumit hipertonic mund të aplikohet në pacientët me hiponatremi të thellë të cilët pritet të realizojnë transplantim të heparit brenda pak ditësh.

Në këto raste, hyponatremia nuk duhet të korrigjohet krejtësisht dhe shpejt, për të shmangur rrezikun nga mielinoliza pontine qendrore që është me e shprehur në cirrozë të avancuar. Në praktikë, pas një korrigjimi të shpejtë fillestar që synon zbutjen e simptomave klinike (5 mmol / L në orën e parë), përqendrimi i natriumit në serum nuk duhet të rritet më shumë se 8 mmol / L në ditë. Infuzioni i albuminës duket se përmirëson përqendrimin e serumit të natriumit, por nevojitet më shumë informacion (147).

5.3.3 Vaptanet

Vaptanet janë antagonistë selektive të receptorëve V2 të arginin-vazopresinës në qelizat kryesore të tubave kolektore që nxisin ekskretimin e ujit (148).

Në të vërtetë, këto barna janë efektive në përmirësimin e përqendrimit të Na në serum në prani të nivele të larta të vazopresinës, si psh në Sindromin e çrregullimit të sekretimit të hormoneve antidiuretike (SIADH) dhe Insuficiencën kardiake. Efektet e administrimit të vaptanëve tek pacientët hiponatremikë me cirrozë dhe ascit janë vlerësuar në disa studime.

Në të vërtetë, tolvaptani, satavaptani dhe lixivaptani çojnë në një rritje të volumit të urinës, një shtim të ekskretimit të ujit dhe një përmirësim të hyponatremisë në 45-82% të rasteve (148). Sidoqoftë, siguria e vaptanëve është vetëm për trajtime afatshkurtra që zgjasin nga një javë në një muaj.

Kur satavaptani u përdor për një kohë të gjatë, përveç diuretikëve, përkundër përmirësimin të përqendrimit të Na në serum dhe kontrollit të ascitit, u raportua një shkallë më e lartë e vdekshmërisë së nga të gjitha shkaktarët, kryesisht e lidhur me komplikimet e njohura të cirrozës krahasuar me trajtimin mjekësor standard.

Megjithatë, shfaqja e dëmtimit të rëndë të heparit në tre pacientë me sëmundje renale polikistike autosomale dominante të trajtuara me tolvaptan në një provë të kontrolluar, bëri që FDA të konkludojë se ky medikament nuk mund të përdoret në pacientët me sëmundje të mëlçisë (149).

5.3.4 Terlipresina

Për shkak të efektit të saj të fortë në receptorin e vazopresinës V1, ka potencial terapeutik në hemorragjinë nga variçet në hipertensionin portal, si dhe në sindromën hepatorenale.

Terlipresina është gjithashtu një agonist i pjesshëm i receptorëve të vazopresinës renale V2, gjë që çon në një ulje të menjëhershme të Na në serum çka është dokumentuar në pacientët që kanë filluar terapinë me terlipresin (150).

Hyponatremia që rezulton, megjithëse e rëndë në disa pacientë, zakonisht është e rikthyeshme pas ndërprerjes së terapisë me terlipresin. Prandaj nivelet e Na në serum duhet të monitorohen gjatë terapisë me terlipresin.

5.4 HEMORRAGJIA GASTRO-INTESTINALE

Hemoragjia akute nga varicet e ezofagut mund të jetë shoqëruar me ascit dhe encefalopati, hemoragjia akute nga varicet është e shoqëruar me mortalitet të lartë. Për këtë arsye, hemostaza endoskopike adekuate dhe parandalimi i relapsit të hemoragjisë janë shumë të rëndësishme.

Qëllimet e trajtimit për hemoragjinë akute nga varicet janë korigjimi i hipovolemisë, arritja e shpejtë e hemostazës, dhe parandalimi i hershëm i komplikacioneve të rihemoragjisë si përkeqsimi i funksionit hepatic.

Nëse dyshohet hemoragjia nga varicet, trajtimi me vazopresor dhe antibiotik duhet të fillojë menjëherë me mbërritjen në spital.

Për më tepër, për të mbajtur hemodinamikën stabël, niveli i hemoglobinës duhet të mbahet $> 8\text{gr/dl}$, presioni sistolik > 90 deri 100 mmHg, frekuenca kardiake < 100 /min. Kur pacienti është me hemodinamikë stabël, duhet realizuar endoskopia sa më shpejt të jetë e mundur.

Për hemoragjinë nga varicet e ezofagut, realizohet zakonisht ligaturë e variceve dhe për varicet gastrike duhet të realizohet obturimi i variceve fillimisht (151).

Afërsisht 50% e pacientëve të diagnostikuar rishtas me cirrozë hepatike kanë varice ezofagu (152); çdo vit, varice të reja zhvillohen ose ato ekzistuese përkeqsohen në 7% të pacientëve (153) dhe hemoragjia e parë ndodh në 12% të pacientëve çdo vit (154).

Faktorët e rrishtit për hemoragjinë nga varicet përfshijnë madhësinë e varices, shenjat e kuqe mbi sipërfaqen e varices, “red spot” dhe shkallën e dëmtimit të funksionit hepatic (155.) Konsumi i alkolit është gjithashtu një faktor rrishtit për hemoragjinë nga varicet. Në një studim pacientët me varice me red spot dhe gradë F2 e lartë, frekuenca e hemoragjisë pas dy vjetësh ishte 57% në ata që vazhduan alkolin krahasuar me 35% te pacientët që nuk pinin (156).

Hemorragjia Variçeale përkufizohet si gjakderdhje nga një varice ezofageale ose gastrike në kohën e endoskopisë ose prania e variceve të mëdha të ezofagut, me gjak në stomak pa praninë e asnjë shkakut tjetër të njohur të hemoragjisë.

Një episod i hemorragjisë është klinikisht i rëndësishëm kur ka një kërkesë për transfuzion për 2 njësi të gjakut ose më shumë brenda 24 orëve të kohës zero, së bashku me një presion sistolik të gjakut prej < 100 mm Hg ose një ndryshim postural prej > 20 mm Hg dhe / ose shkalla e pulsit > 100 bpm në kohën zero (koha zero është koha e pranimit në spitalin e parë në të cilin merret patient).

5.4.1 Koha e hemorragjisë akute

Episodi i gjakderdhjes akute përfaqësohet nga një interval prej 120h (5 ditë) nga koha zero. Dëshmia e ndonjë gjakderdhjeje pas 120 h është episodi i parë rihemorragjisë.

5.4.2 Dështimi i kontrollit të hemorragjisë aktive

Dështimi për të kontrolluar gjakderdhjen aktive përcaktohet si vdekje ose një nga kriteret e mëposhtme:

-Hematemezë e freskët npr aspirimit nga sonda nazogastrike i ≥ 100 mL gjaku të freskët, ≥ 2 h pas fillimit të terapisë specifike medikamentoze ose procedurës endoskopike.

-Shfaqja e shokut hipovolemik.

-Rënia e vlerës së hemoglobinës me 3 g/dl (rënie e vlerës së hematokritit me 9%) brenda 24 oreve, pa marrë asnjë hemotransfuzion.

5.4.3 *Diagnoza e variçeve gastro-ezofageale*

Deri kohët e fundit, endoskopia është përdorur ekskluzivisht për të diagnostikuar variçet. Metodat jo invazive të shqyrtimit për variçe përfshijnë kapsul endoskopinë, elastografinë e përkohshme dhe përdorimi i gjetjeve laboratorike dhe radiologjike.

5.4.4 *Fiziopatologjia*

Hemorragjia Variçuale (HV) ndodh për shkak të rupturës së paretit të enës varikoze si rezultat i presionit të lartë që ushtrohet mbi paret.

Presioni i paretit të variçes është një forcë e brendshme e murit të enëve që kundërshton forcën e ushtruar nga presioni transmural variceal, i cili varet nga presioni i portës dhe madhësia e enës së gjakut. Mbështetja e indit përreth varices mund të neutralizojë rritjen e presionit dhe madhësisë e enës së gjakut, duke mbrojtur muret nga ruptura (157).

Pas shfaqjes së rupturës së murit të venës varikoze, sasia e hemorragjisë që shfaqet, varet nga presioni transmural (i cili kryesisht varet nga presioni i portës), nga sipërfaqja e zonës së riptuar në muret e enëve dhe nga viskoziteti i gjakut dhe / ose ndryshimet e hemostazës (158). Të gjithë këta faktorë në mund të modifikojmë nëpërmjet terapive medikamentoze.

Terapia e barnave dhe procedurat derivative porto-sistemike, reduktojnë presionin portal (dhe variceal).

Terapitë endoskopike dhe metoda të tjera fizike, të tilla si tamponadat e balonave ose proteza të zgjerueshme, veprojnë thjesht duke ndërprerë rrjedhjen e gjakut në enën varikoze dhe saldimin e murit të enëve të gjakut.

Presioni në venen porta është një faktor kyç që përcakton edhe ripturën në enën varikoze dhe gravitetin e episodit të hemorragjisë (158).

Gjatë hemorragjisë akute, presioni i venës porta mund të rritet për shkak të faktorëve të ndryshëm si transfuzioni ose absorbimi i gjakut nga intestini, të cilat ndikojnë në dështimin e tentativës për të kontrolluar hemorragjinë dhe / ose precipitimin e rishfaqjes së hemorragjisë. Presioni i venës porta zakonisht vlerësohet nga gradienti i presionit hepatic venoz (HVPG).

5.4.5 *Ecuria natyrore e variceve gastro-ezofageale dhe hemorragjise variceale.*

Hemorragjia nga varicet shkakton rreth 70% të të gjitha hemorragjive të sipërme GI në pacientët me hipertension portal, dhe mbetet një ndër komplikimet më të rënda dhe jetëkërcënuese në Hemorragjia nga varicet shkakton rreth 70% të të gjitha hemorragjive të sipërme GI në pacientët me hipertension portal, dhe mbetet një ndër komplikimet më të rënda dhe jetëkërcënuese në pacientët me cirrozë dhe përbën komplikacionin e dytë më të shpeshtë të dekompensimit pas ascitit (159).

Pacientët e dekompenuar kanë hipertension portal klinikisht të rëndësishëm' dhe, rrjedhimisht, një rrezik të lartë për të pasur varice gastro-ezofageale. Në fakt, ndërsa vetëm 42% e pacientëve CHILD A kanë varice gastro-ezofageale, rreth 72% e pacientëve me CHILD B dhe C shfaqin praninë e variceve(160).

Kur zhvillohet dekompensimi, pacientët pa varice në një endoskopi të mëparshme duhet të përsërisin endoskopinë duke marrë parasysh rrezikun e zhvillimit të variceve për shkak të përkeqësimit të hipertensionit portal dhe insuficiencës hepatike.

Në pacientët pa varice në screening, varicet " de novo " zhvillohen me një frekuencë prej 7-8% në vit,(153) që mund të jenë më të larta në pacientët e dekompenuar për shkak të përkeqësimit të hipertensionit portal dhe insuficiencës hepatike.

Shkalla e progresionit nga varice të vogla në ato të mëdha varion deri në 22% në një vit dhe 51% në tre vjet në pacientët me cirrozë CHILD B / C, sidomos në ato me origjinë etilike dhe / ose kur janë të pranishme që në endoskopinë e parë Red Spots krahasuar me 2% dhe 16% respektivisht në pacientët e kompensuar pa këto faktorë rreziku(163).

Studime në vazhdim kanë treguar vazhdimisht se rreziku i Hemorragjise variceale, i vlerësuar përgjithësisht në 5-15% në vit, është i lidhur me madhësinë e variceve (162).

Ky rrezik është përforcuar më tej nga graviteti i insuficiencës hepatike (Child B / C) dhe / ose praninë e Red Spots në varice.

Kështu, jo vetëm varicet e mesme / të mëdha (p.sh. varices që nuk kolabohen nga insufllimi në endoskopi), por edhe varicet të vogla me Red Spots ose në CHILD C duhet të konsiderohen varice me 'rrezik të lartë'.

Përkundër përmirësimit në terapi, vdekshmëria e përgjithshme me secilin episod të Hemorragjise variceale mbetet rreth 15% në 25% në gjashtë javë.

Rreziku i tillë është shumë më i lartë në pacientët të cilët zhvillojnë Hemorragji variceale, të cilët kanë zhvilluar dhe shfaqje të tjera të dekompensimit (mbi 80% në pesë vjet) sesa në ato që paraqesin Hemorragjinë variceale si një episod të izoluar të dekompensimit (20% në pesë vjet) (164).

Rreziku i vdekshmërisë është veçanërisht i lartë kur hemorragjia është e lidhur me AKI dhe / ose infeksionet bakteriale shoqëruese (162, 170).

Pa profilaksinë dytësore, rishfaqja e hemorragjisë ndodh në rreth 60% deri në 70% të pacientëve, zakonisht brenda një deri në dy vjet të ngjarjes hemorragjike të pare.(165)

Duke pasur parasysh prevalencën e lartë të 'variceve me rrezik të lartë' në cirrozën e dekompenzuar, ezofago-gastroduodenoscopia (EGD) duhet të kryhet për të zbuluar praninë , madhësinë e variceve dhe praninë e Red Spots (165).

5.4.6 Parandalimi dhe trajtimi i hemorragjise variceale.

Duke marrë parasysh rrezikun e lartë të vdekjes nga Hemorragjia variceale në pacientët me cirrozë të dekompenzuar, zbatimi i strategjive për të trajtuar në mënyrë adekuate Hemorragjinë variceale dhe për të parandaluar ripërsëritjen e hemorragjisë dhe vdekjen duhet të ndiqet në mënyrë aktive në pacientët me cirrozë dekompenzuar.

5.4.6.1 Profilaxia primare dhe sekondare për Hemorragjinë variceale në pacientët e dekompenzuar

Konsensusi i VI i Baveno (166, 169) dhe Shoqata Amerikane për Studimin e Sëmundjeve të Mëlçisë (AASLD) (167) rekomandojnë kryesisht NSBB (non-selective beta-blockers) për profilaksinë primare të Hemorragjisë variceale në pacientët me cirrozë që kanë varice me rrezikshmëri të lartë(168) dhe gjithashtu, të kombinuara me ligaturën endoskopike (EBL), për profilaksinë sekondare në Hemorragjinë variceale.

Të dy NSBBs dhe EBL kanë treguar të jenë po aq efektive në parandalimin e episodit të parë të hemorragjisë në pacientët me varice me rrezik të lartë. Zgjedhja midis opsioneve varet nga faktorë të tillë si preferencat e pacientit, kundërindikacionet ose ngjarjet e padëshirueshme.

Megjithëse EBL shkakton më pak efekte anësore, ajo është e lidhur me komplikime më të rënda dhe potencialisht kërcënuese për jetën, që rezultojnë nga hemorragjia e ulçeracioneve të EBL. Për më tepër, EBL nuk ndikon në hipertensionin portal. Prandaj, nuk redukton apo parandalon ndërlikimet e tjera dhe kërkon përsëritje të endoskopisë për të zbuluar përsëritjen e variceve, duke mbështetur preferencën e përgjithshme primare për NSBB (171, 172).

Për parandalimin e rishfaqjes së hemorragjisë (profilaksia sekondare) rekomandohet terapi e kombinuar me NSBBs plus EBL sepse terapia e kombinuar ul ndjeshëm probabilitetin e rishfaqjes së hemorragjisë krahasuar me monoterapi duke përdorur ose EBL ose terapi medikamentoze. NSBBs janë elementi kyç i terapisë së kombinuar, sepse një meta-analizë tregon një përmirësim në mbijetesë me shtimin e NSBBs (\pm nitrateve) në EBL, ndërsa shtimi i EBL tek NSBBs (\pm nitratet) nuk ka efekt mbi vdekshmërinë.

NSBBs, të tilla si propranolol dhe nadolol, veprojnë në hipertensionin portal sepse beta-blokada jo-selektive zvogëlon prodhimin kardial dhe rrjedhjen e gjakut splanik, ndërkohë që efekti i

receptorëve alfa-1 adrenergik çon në vazokonstriksionin splanik, duke reduktuar presionin e portal dhe komplikimet e tij pasuese.

Sidoqoftë, normat e reagimit hemodinamik ndaj NSBBs janë modeste: rreth 46% e rasteve sipas meta-analizave, (172) që mbështesin kërkimin e përgjithshëm për opsionin e ri terapeutik.

Karvediloli, një NSBB me aktivitet të receptorit të brendshëm anti-alfa-1 shoqërohet me një zvogëlim më të madh të presionit portal sesa NSBB tradicionale dhe është bërë kështu një alternativë e vlefshme (173).

Veprimi i tij i dobishëm në receptorët alfa-1 redukton rezistencën porto-kolaterale dhe rezistencën intrahepatike, megjithatë, kjo shoqërohet me koston e efekteve më të thella në presionin arterial sistematik, veçanërisht në pacientët e dekompenzuar. Problemi me të gjitha rekomandimet e përmendura deri më tani është se ato bazohen në RCT me kualitet të lartë që zakonisht përjashtojnë pacientët me cirrozë më të avancuar, ndërkohë që gjatë viteve të fundit është shfaqur një polemikë e madhe lidhur me përdorimin dhe sigurinë e NSBBs në pacientët me sëmundje të avancuar, ato me ascit refraktar dhe / ose SBP.

Diskutimi u iniciua nga grupi Clichy, (174) i cili raportoi mbijetesë të dobët dhe rritje të rrezikut të PPCD në mesin e pacientëve me ascit refraktare në terapi NSBB (175).

5.4.7 Trajtimi i hemoragjisë aktive variceale:

5.4.7.1. Trajtimi medikamentoz

Dy klasat kryesore të medikamenteve që janë përdorur në kontrollin e hemorragjisë akute variceale janë vazopresina ose analogët e saj (ose vetëm ose në kombinim me nitroglicerinë) dhe somatostatina ose analogët e saj.

Terlipresina është i vetmi agjent që është treguar të reduktojë vdekshmërinë në provat e kontrolluara me placebo.

Megjithatë, në provat që krahasojnë terlipresinën, somatostatinën dhe octreotide, asnjë ndryshim nuk është identifikuar në efikasitetin e tyre (176).

Antibiotikët si profilaksi mund të rezultojnë në një përfitim të ngjashëm të mbijetesës pas hemorragjisë akute variceale (177).

- **Vasopresina**

Vasopresina redukton fluksin e gjakut në sistemin portal, fluksin e gjakut në sistemin kolateral portal dhe presionin variceal. Sidoqoftë, ajo ka efekte të rëndësishme anësore sistemike siç është rritja e rezistencës periferike, ulja e prodhimit kardiak, frekuencës kardiake dhe fluksit të gjakut në a. koronare.

- **Vasopresina me nitroglicerinë**

Shtimi i nitroglicerines rrit efektin e vazopresinës në presionin e portës dhe redukton efektet anësore kardiovaskulare (178). Meta-analiza e tri studimeve të randomizuara që krahasojnë vetëm vazopresinën me vasopresinë dhe nitroglicerinë treguan se kombinimi ishte shoqëruar me një

reduktim të ndjeshëm në dështimin për të kontrolluar hemorragjinë, ndonëse nuk uarrit asnjë përfitim në mbijetesë.

- ***Terlipresina***

Terlipresina është një analog sintetik i vazopresinës, i cili ka një veprim vasokonstriktor sistematik të menjëhershëm pasuar nga efektet hemodinamike portale për shkak të konvertimit të ngadaltë në vazopresin. (150) Doza e rekomanduar e terlipresinës është 2 mg iv çdo 4 orë, edhe pse shumë njësi e zvogëlojnë dozën deri në 6 orë pasi mund të shkaktojnë vazokonstriksion periferik që manifestohet me duar e këmbë të dhimbshme.

- ***Somatostatina dhe octreotidi***

Somatostatina shkakton vazokonstriksion splanik selektiv dhe redukton presionin e portal dhe fluksin e gjakut në portë (115). Oktreotidi është një analog I somatostatines. Mekanizmi i veprimit të këtyre dy agjentëve nuk është i qartë.

Veprimet e oktreotidit në hemodinamikën hepatike dhe sistemike janë të përkohshme, duke e bërë të nevojshme infuzionin e vazhdueshëm.

Octreotidi jepet si një bolus 50 µg i ndjekur nga një infuzion prej 25-50 µg / h.

Somatostatina jepet si një bolus intravenoz 250 mg i ndjekur nga një infuzion prej 250 mg / h. Somatostatina dhe octreotide janë treguar të efektshme si terlipresina në hemorragjinë akute variçuale.

- ***Antibiotiket***

Antibiotikët që ofrojnë mbulim për Gram-negativët janë një nga ndërhyrjet që ndikojnë pozitivisht në mbijetesë në hemorragjinë variçuale.

Prandaj, antibiotikët afatshkurtër duhet të konsiderohen praktikë standarde në të gjithë pacientët me cirrozë që kanë një hemorragji variçuale, pavarësisht nga prania e infeksionit të konfirmuar. Cefalosporina të gjeneratës së tretë, siç është ceftriaksoni (1 g/iv, në ditë), janë treguar të jenë më efektive në reduktimin e sepsis për Gram-negativët sesa norfloxacinë në rrugë orale (177), por zgjedhja e antibiotikëve duhet të diktohet nga modelet e rezistencës lokale dhe disponueshmëria.

- ***Inhibitorët e pompës protonike***

Nga studimet nuk është parë të luajnë ndonjë rol në ndalimin e hemorragjisë variçuale dhe në mbijetesë.

5.4.7.2. *Terapia endoskopike*

Endoskopia duhet të bëhet brënda 24 orëve të pranimit dhe më herët nëse ka hemorragji të tepërt (179). Ndonëse shumë udhëzime dhe rishikime sugjerojnë që endoskopia duhet të kryhet brenda 12 orëve, studimi i vetëm që shqyrtoi ndikimin e kohës në rezultat nuk arriti të demonstrojë ndonjë avantazh të endoskopisë para 12 h. Koha optimale është pas reanimimit të mjaftueshëm dhe trajtimit farmakologjik, me endoskopinë e kryer nga një ekip i aftë endoskopie, në njësi të reanimacionit të përgjithshëm dhe me mbrojtjen e rrugëve të frymëmarrjes.




Figura 8. Profilaksia primare e hemoragjisë variceale të ezofagut. NSBB: Beta-bllokues jo selektiv; EVL: Lidhja endoskopike variceale.

Ligatura e variceve

Kjo teknikë është një modifikim i asaj që përdoret për lidhjen elastike të hemorroideve të brendshme. Përdorimi i saj në njerëz u përshkrua për herë të parë në 1989 nga Stiegmann dhe Goff te cilet futen për herë të parë në praktiken klinike ligaturen e variceve të ezofagut me endoskopi (181).

Një meta-analizë e shtatë testeve që krahasonin EVL (endoscopic variceal ligation) me skleroterapinë në gjakderdhje akute treguan se EVL reduktoi rishfaqjen e hemorragjisë nga varicet, vdekshmërinë e reduktuar dhe rezultoi në më pak striktura ezofageale (180).

Numri i sesioneve të kërkuara për të zhdukur varicet ishte më i ulët me EVL.

Në kontrast me skleroterapinë, EVL obliteron varicet duke shkaktuar strangulim mekanik me rripa gome. EVL konsiston në vendosjen e unazave të gomës përgjatë variceve.

Zakonisht eradikimi i variceve kërkon 2 deri në 4 seanca ligature (182).




Figura 9. Imazhe të marra gjatë realizimit të ligaturës së variceve ezofageale në rrugë endoskopike.

Skleroterapia

Skleroterapia është zëvendësuar nga VBL dhe nuk duhet të ofrohet si standard i kujdesit në hemorragjine akute variceale.




Figura 10. Realizimi i skleroterapisë me endoskopi

Metoda të tjera endoskopike

Cianoacrilate nuk ofroi asnjë përfitim për VBL, me rrezikun shtesë të embolizimit dhe tendencën drejt rishfaqjes së hemorragjise me cianoacrilate (183).

Pluhuri Haemostatic (TC-325; Hemospray; Cook Medical, USA) është përshkruar në një studim të vogël të nëntë pacientëve të cilët kanë marrë trajtim endoskopik me spray për hemorragji akute variceale. Studimi raportoi se kishte rishfaqje të hemorragjisë brenda 24 orëve.

- **Tamponada me balona**

Tamponada me balona është shumë e efektshme dhe kontrollon hemorragjinë akute deri në 90% të pacientëve, ndonëse rreth 50% rishfaqin hemorragji kur balloni është shfryrë (184).

Megjithatë, ajo është e lidhur me komplikime serioze të tilla si ulçeracione ezofageale dhe pneumoni aspirative në deri në 15 -20% e pacientëve (185).

Përkundër kësaj, mund të shpetojë jetën në rastet e hemoragjive masive të pakontrolluara nga variçet në pritje të formave të tjera të trajtimit.

Një tub i vendosur në mënyrë adekuate Sengstaken-Blakemore lejon mundësi për reanimim, transport të sigurt dhe ose endoskopi të përsëritur ose shuntim radiologjik në një pacient me një sistem të qëndrueshëm kardiovaskular. Balona ezofageale kërkohet rrallë, nuk duhet të përdoret më vete dhe duhet të përdoret vetëm nëse ka gjakderdhje të vazhdueshme edhe përkundër një baloni gastrik të fryrë në mënyrë adekuate dhe me tension të përshtatshëm.

Vendosja e tubit endoskopikisht ose nëpërmjet një gide drejtuese mund të zvogëlojë rrezikun e komplikimeve, sidomos rupturën e ezofagut.




Figura 11. Sonda Blakemore

5.4.7.3. Shunti transjugular intrahepatik portosistemik TIPS

Disa studime të pavarura kanë treguar se TIPS është efektiv në uljen e presionit të rritur portal në pacientët me hemoragji refraktare, ka komplikacione postprocedure dhe mortalitet të pranueshëm, dhe në një minoritet pacientësh përkeqsim të encefalopatisë .

Rekurenca për hemoragji nga variçet pas TIPS është e ulët dhe lidhet me stenozen ose okluzionin e shuntit.(187)




Figura 12. *Profilaksia sekondare për varicet e ezofagut*

5.4.7.4. Stenta ezofageale të lëvizshme

Stenti SX-Ella Danis (ELLA-CS, Hradec Kralove, Republika Çeke) është një stent i rrëshqitshëm metalik i mbuluar që vendoset endoskopikisht në ezofagun e poshtëm pa mbikëqyrje radiologjike (186).

Nuk ka rol në menaxhimin e gjakderdhjes variçeale të stomakut. Këto stentë mund të lihen in situ deri në 2 javë ndryshe nga Sonda Sengstaken-Blakemore e cila duhet të hiqet pas një periudhe maksimumi prej 24-48 h.

5.4.7.5. Transplantimi hepatic

Transplanti ndoshta është i përshtatshëm vetëm për pacientët që kanë hemorragji dhe janë në pritje të transplantimit të mëlçisë. Transplantimi i mëlçisë është një mundësi jashtëzakonisht e rrallë për shumicën dërrmuese të pacientëve, për shkak se nuk është zakonisht i disponueshëm dhe për shkak të mungesave dhe vonesave në prokurimin e organeve. Nuk ka studime mbi transplantimin e mëlçisë në hemorragji të pakontrolluar aktive.

5.5 PERITONITI BAKTERIAL SPONTAN

Peritoniti bakterial spontan (SBP) është një term që përdoret për të përshkruar infeksionin akut të likidit ascitik në pacientët cirrotik pa një burim të identifikueshëm të infeksionit (188,189).

SBP gjithmonë ndodh në pacientët cirrotik me ascit dhe suspektohet kur pacienti paraqet dhimbje abdominale, temperaturë ose alterim të gjendjes mentale.

5.5.1 Etiologjia:

SBP është më së shumti (75%) i shkaktuar nga mikroorganizmat aerob gramnegativ si *Clebsiella pneumoniae* (50% të rasteve).

Mikroorganizmat aerobik gram pozitiv përfshijnë *Streptococcus pneumoniae* (190).

Likidi ascitik ka një tension të lartë të oksigjenit. Për këtë arsye mikroorganizmat anaerobik nuk janë të pranishme.

Në shumicën e rasteve të SBP, vetëm një mikroorganizëm është i përfshirë (92%), pjesa tjetër e rasteve janë raportuar si polimikrobiale.

Pacientët me cirrozë të dekompenzuar janë me rrisht të lartë për të zhvilluar SBP. Mikroorganizmat patogjen origjinojnë nga lumeni i zorrës, nga aty ato kalojnë në limfonodulat mezenteriale.

Faktoret e rrishtit për SBP përfshijnë histori të mëpaeshme të SBP, ulje të titrit të komplementit, reduktimi i sintezës hepatike të proteinave me një rritje të kohës së protrombinës dhe reduktim i proteinave në ascit (më pak se 1gr/dl), përdorimi për kohë të gjatë i PPI i cili rrit pH gastrik dhe nxit rritjen e bakteve të zorrës dhe translokacionin e tyre.

5.5.2 Fizipathologjia:

Pjesa më e madhe e organizmave të izoluar në SBP (90%) janë organizmat enterik gram-negativ si *Escherichia Coli* ose *Clebsiella pneumoniae*, që sugjerojnë që burimi primar i kontaminimit është trakti gastrointestinal.

Një mekanizëm alternativ i kontaminimit përfshin shpërndarjen hematogjene, nga një burim i largët si infeksioni i taktit urinar në pacientët me një sistem të dobësuar imunitar.

Pacientët me cirrozë zakonisht kanë një nivel të rritur të mbipopullimit bakterial të intestinit për shkak të tranzitit të zgjatur intestinal (191).

Pacientët që janë në rrisht të zhvillojnë SBP:

Pacientët me hemoragji gastrointestinale dhe cirrozë.

Pacientët që kanë pasur episode të mëparshme të SBP.

Pacientët cirrotik me ascit në të cilin proteina në likid është <1.5gr/dl së bashku me insuficiencën renale (kreatinina >1.2mg/dl). Pacientët cirrotik të hospitalizuar për një shkak tjetër dhe që kanë një përqëndrim të proteinës në ascit < 1gr/dl.

5.5.3 Diagnoza

Diagnoza e SBP bazohet në paracentezën diagnostike (192,193).

Të gjithë pacientët me cirrozë dhe ascit janë në rrezik për SBP dhe prevalenca e SBP në pacientët ambulatorë është 1.5-3.5% dhe 10% në pacientët e hospitalizuar (194).

Gjysma e episodeve të SBP janë të pranishme në momentin e shtrimit në spital ndërsa pjesa tjetër merret gjatë hospitalizimit.

Pacientët me SBP mund të kenë një të një nga këto shenja: i) simptoma lokale dhe / ose shenja të peritonitit: dhimbje abdominale, sensibilitet abdominal, të vjella, diarre, ileus; ii) shenjat e inflamacionit sistematik: hiper ose hipotermi, dridhje, alterim i numrit të qelizave të bardha të gjakut, takikardi dhe / ose tachypnoea; iii) përkeqësimi i funksionit të mëlçisë; iv) encefalopati hepatike; v) gjendje shoku; vi) insuficiencë renale ; dhe, (vii) hemorragji G-I.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se SBP mund të jetë asimptomatike, veçanërisht në pacientët ambulator (195).

Në një studim vëzhgimor në pacientë me SBP, Paracenteza diagnostike e vonuar (> 12 h pas pranimit) ishte shoqëruar me një rritje 2,7-fish në vdekshmërinë e pacieteve.

Infeksioni peritoneal shkakton një reaktion inflamator që rezulton në një numër në rritje të neutrofileve në likidin ascitic.

Pavarësisht përdorimit të metodave të ndjeshme, kultura e ascitit është negative në 60% të pacientëve me klinikë që shkon për SBP dhe me një numër të rritur të neutrofileve në ascit.

Standardi i artë për numërimin e neutrofileve në ascit është mikroskopia manuale, e cila është një punë intensive dhe shoqërohet me ndryshueshmërinë e vëzhguesve, kohën dhe kostot e larta (195).

Në shumicën e vendeve kjo është zëvendësuar me metoda të automatizuara bazuar në citometrinë për numërimin dhe diferencimin e qelizave.

Ndjeshmëria më e madhe për diagnozën e SBP arrihet me një vlerë cutt-off për numrin e neutrofileve prej 250 / mm³, edhe pse specifika më e madhe është të arrihet me një prerje prej 500 neutrofile / mm³. Përdorimi i reagenteve në formë strip nuk rekomandohet për diagnozën e shpejtë të SBP(196).

Kultura e ascitit është thelbësore për të udhëhequr terapinë antibiotike. Pacientët me numërim të neutrofileve të likidit ascitic ≥ 250 qeliza / mm³ dhe kulturë negative kanë kulturë-negative SBP (197).

Prezantimi i tyre klinik është i ngjashëm me atë të pacientëve me kulturë pozitive për SBP dhe duhet të trajtohet në mënyrë të ngjashme. Disa pacientë kanë "ascit bakterial" në të cilat kulturat janë pozitive, por ka numërim normal të neutrofileve në ascit (<250 / mm³) (198). Në disa pacientë, asciti me prani të bakteve janë rezultat i kolonizimit bakterial dytësor të ascitit nga një infeksion extraperitoneal, të cilët zakonisht kanë simptoma të përgjithshme dhe shenjat e infeksionit.

Në pacientë te tjerë kjo vjen për shkak të kolonizimit spontan të ascitit, dhe mund të jenë klinikisht asimptomatik ose të çojë në dhimbje të barkut ose ethe.

Ndërsa në disa pacientë, veçanërisht në ata që janë asimptomatikë, asciti bakterial përfaqëson një kolonizim spontan dhe kalimtar të ascitit, të rikthyeshëm, ndërsa në ata që janë simptomatikë kjo mund të përfaqësojë hapin e parë të zhvillimit të SBP.

5.5.3.1. Empiema bakteriale pleurale spontane

Infeksioni i një hidrotoraxi pre-ekzistues, i njohur si empiemë pleurale spontane bakteriale, është i pazakontë. Një studim ka ndjekur 3,390 pacientë me cirrozë për katër vjet dhe e ka vërejtur atë në 2.4% të popullsisë së përgjithshme dhe 16% të pacientëve me hidrotoraks ekzistues, me një vdekshmëri të lidhur prej 38% (200). Diagnoza bazohet në analizën e likidit pleural të marre nga torakocenteza diagnostikuese. Në studimin më të madh vëzhgimor të raportuar deri më tani, u krijua diagnoza e empiemës bakteriale spontane kur analiza e likidit pleural tregoi një kulturë pozitive dhe më shumë se 250 neutrofile / mm³ ose një kulturë negative dhe më shumë se 500 neutrofile / mm³, në mungesë të një infeksioni pulmonar. Kultura e Likidit Pleural në shishet e kulturës së gjakut ishte pozitiv në 75% të rasteve. Empiema pleurale spontane bakteriale është e lidhur me SBP në 50% të rasteve (199).

5.5.3.2. Peritoniti bakterial sekondar

Një përqindje e vogël (5%) e pacientëve me cirrozë mund të zhvillojnë peritonit për shkak të perforacionit ose inflamacionit të një organi intraabdominal, një gjëndje e njohur si peritonit bakterial sekondar (201). Është e rëndësishme diferencimi i kësaj gjëndje nga SBP. Peritoniti bakterial sekondar duhet të dyshohet tek pacientët të cilët kanë simptoma ose shenja abdominale të lokalizuara, nga prania e organizmave të shumta dhe të ndryshme në kulturën e ascitit, numër shumë të lartë të neutrofileve në ascit dhe / ose koncentrimin e lartë të proteinave në ascit, ose në ato pacientë me një përgjigje të papërshtatshme ndaj terapisë. Pacientët me peritonit bakterial sekondar të dyshuar duhet t'i nënshtrohen shpejtë CT abdomenit dhe ekzaminimit të hershëm kiruegjikal.

5.5.4 Diagnoza diferenciale

1. Perforacioni i viscerave
2. Abscesi perinefrik
3. Pielonefriti
4. Apendisiti
5. Ischemia e mezenterit

5.5.5 Prognoza

Mortaliteti i lidhur me SBP është ulur së fundmi me trajtimin e duhur dhe adekuat. Megjithatë, mortaliteti është gati i lartë në ata pacientë që zhvillojnë sepsis. Por me antibioterapinë e përdorur së fundmi (kinolonet e gjeneratës së tretë), janë arritur rezultate më të mira. Në pacientët e hospitalizuar, mortaliteti i SBP mund të jetë 20-40%, dhe ai pas një dhe dy vjetësh është 70 dhe 80% respektivisht (206).

5.5.6 Komplikacionet :

1. Insuficienca renale
2. Sepsis
3. Insuficienca hepatike
4. Asciti masiv
5. Hemoragjia pas paracentezës
6. Perforacioni i zorrës pas paracentezës
7. Peritoniti spontan fungal

5.5.7 Parandalimi dhe edukimi i pacientit:

1. Trajtimi agresiv i hemoragjise akute gastrointestinale
2. Pacientët me përqëndrim të proteinës në ascit $< 1\text{gr/dl}$ duhet të hospitalizohen.
3. Pacientët që kanë një histori të mëparshme SBP duhet të trajtohen ambulatorisht me antibioterapi orale për një kohë të gjatë (baktrim ose ciprofloksacin/norfloksacin).

5.5.8 Trajtimi, menaxhimi i PBS:

Terapia empirike me antibiotikë, sic është gjenerata e 3të e cefalosporinave e administruar i/v, duhet të jetë standarte e të gjithë pacientëve me SBP të dyshuar dhe me një PMN >250 qeliza/microlitër në analizën e likidit ascitik. Përrjashtime nga ky rregull prfshijnë pacientët me ekspozim së fundmi nga antibiotikët beta-laktamik.

Antibiotikët duhet të zgjidhen duke u bazuar në rezultatet e testeve si kultura e likidit (202,203,204).

Pacientët me likid ascitik me një numër të PMN >500 qeliza/ui, duhet të trajtohen me antibioterapi empirike sa më shpejt të jetë e mundur dhe më pas përshtasim antibiotikët në bazë të kulturës së likidit.

Një analizë e likidit ascitik që numëron PMN duhet të bëhet sa më shpejt për të siguruar që pacienti të marrë antibiotikun e duhur në kohën e duhur.

Mungesa e përmirimit pas 48 orësh të terapisë së filluar mund të sugjerojë për perforimin ose formimin e absesit, sic është peritoniti baterial spontan, i cili kërkon kirurgji.

Në përgjithsi, numri i PMN duhet të reduktohet me të paktën 25% pas 48 orësh të terapisë me antibiotik.

Disa pacientë cirrotik me SBP dhe me kreatinin >1mg/dl, azot >30mg/dl, ose një bilirubin totale >4 mg/dl, duhet ti jepen terapi shtesë si albumina intravenoze.

Kjo ka treguar që ka reduktuar si mortalitetin spitalor dhe dëmtimin renal krahasuar me përdorimin vetëm të antibiotikëve.

Pacientët me rrisht të lartë mund të përfitojnë nga terapia profilaktike ambulatorie duke përfshirë norfloksacinën, ciprofloksacinën ose baktrimën.

Një shqetësim i lidhur me antibioterapinë profilaktike është antibiotikorezistenca, vecanërisht në ata pacientë që përdorin fluorokinolone si profilaksi për SBP.

Në këta pacientë cefotaxima është zgjedhja e duhur (205).

5.5.8.1. Albumina intravenoze në pacientët me Peritonit bakterial spontan

SBP pa shokun septik mund të precipitojë funksionit të qarkullimit të gjakut me insuficiencë të rëndë të heparit, encefalopati hepatike dhe HRS tipi 1 dhe e ka afërsisht 20% vdekshmërinë spitalore pavarësisht zgjidhjes së infeksionit (207).

- Ka një shoqërim pozitiv mes sëmundjeve të mëparshme dhe zhvillimit të cirrozës në pacientët e diagnostikuar me këtë patologji.
- Ka një shoqërim pozitiv ndërmjet ndërlikimeve të Cirrozës si pasojë e dilatacionit arterial dhe qarkullimit hiperdinamik.
- Ka një lidhje positive ndërmjet komplikacioneve si asciti, insuficenca hepatike akute e mbivendosur mbi atë kronike dhe shkaktarit të Cirrozës Hepatike.
- Ka një lidhje positive ndërmjet faktorit etiologjik viral të cirrozës Hepatike të Dekompensuar dhe zhvillimit të Hepatokarcinomës.

III METODOLOGJIA

Në këtë kapitull të punimit trajtohen me hollësi të mjaftueshme të gjitha materialet dhe metodat e përdorura në studimin aktual duke përfshirë të gjithë aspektet metodologjike dhe shkencore si :

- Lloji, tipi i studimit
- Periudha kohore e kryerjes së punimit shkencor
- Popullata në studim dhe procedurat e rekrutimit të pacientëve
- Mbledhja e të dhënave dhe informacionit klinik dhe social-demografik, dhe të gjitha të dhënat e tjera të përfshira në kuadrin e këtij punimi.
- Përkufizimin e të gjitha të dhënave (variablave) të përfshira në studim si dhe
- Analiza statistikore e të dhënave të mbledhura në kuadrin e këtij studimit.

3.1 Tipi (ose lloji) i studimit

Punimi shkencor aktual mund të konsiderohet si një studim rast-seri (“case-series”), meqenëse kishte të bënte me përfshirjen e një kontigjenti (seri rastesh) klinike të diagnostikuar në Spitalin Rajonal Durrës.

Nga pikëpamja metodologjike, studimet rast-seri janë studime që konsistojnë në rekrutimin e një grupi (kontigjenti) pacientësh të cilët kanë të njëjtën karakteristikë qoftë kjo diagnose apo patologji klinike, apo ndonjë karakteristikë tjetër e përbashkët (homogjene) në të gjithë individët e përfshirë në studim (296).

Këto lloj studimesh në fakt nuk kanë grup kontrolli dhe, si të tillë, nuk rreken që të hetojnë lidhje shkakësore mes agjentëve të ndryshëm etiologjikë (faktorëve që ndërhyjnë në etio-patogjenezën e sëmundjeve) dhe pasojave apo ngjarjeve shëndetësore të ndryshme (296).

Gjithsesi, qasjet e tipit rast-seri janë shumë të volitshme dhe mjaftueshmërisht të mira për të vlerësuar shpërndarjen e karakteristikave të ndryshme dhe përcaktimin e profilit klinik në një kontigjent (seri) pacientësh me një sëmundje të caktuar. Pikërisht kjo veti e studimeve rast-seri u shfrytëzua edhe në punimin aktual të udhëhequr në Durrës.

Zakonisht, studimet rast-seri mund të përfshijnë një kontigjent (grup) të njëpasnjëshëm pacientësh, me qëllim që të përjashtojnë ose të shmangin sa më shumë mundësinë e gabimit sistematik të seleksionit (përzgjedhjes).

Ky lloj gabimi sistematik konsiston në pamundësinë e përfundimit të kampioneve probabilitare, si parakusht i vetëm për të garantuar përfaqësueshmëri të pacientëve të përfshirë në studim me të gjithë individët e populates (296).

Nga ana tjetër, studimet rast-seri mund të ndërmerren (kryhen) në një kontigjent (grup) jo të njëpasnjëshëm pacientësh, e lidhur kjo me marrjen (rekrutimin) vetëm të një kampioni të pacientëve përgjatë një periudhe kohore të caktuar.

Gjithsesi, marrja e kampioneve të tilla duhet të jetë probabilitare si premisë themelore për të shmangur gabimin sistematik të përzgjedhjes (seleksionit), me qëllimin final garantimin e përfaqësueshmërisë së kampionit për të gjithë popullatën të cilës i referohen (ekstrapolohen) rezultatet e studimit (296).

Në studimin aktual u përfshi një kampion probabilitar (pra, përfaqësues) nga të gjithë pacientët e hospitalizuar në Spitalin Rajonal Durrës gjatë një periudhe kohore katër vjeçare. Prandaj, ky studim përfshiu një kontigjent (grup)jo të njëpasnjëshëm pacientësh, por një kampion probabilitar (përfaqësues) të tyre.

Fakti që kampioni ishte probabilitar garanton përgjithësim të rezultateve të këtij studimi në të gjithë popullatën referencë (d.m.th., në të gjithë pacientët e diagnostikuar me cirozë hepatike në vendin tonë).

Nga këndvështrimi i qëllimit apo objektit të kërkimit shkencor, studimet rast-seri kanë kryesisht karakter deskriptiv (përshkrues), meqenëse janë studime pa një grup krahasimi (sepse përfshijnë grupe homogjene individësh apo pacientësh me të njëjtën karakteristikë, ose sëmundje të interesit) (296).

Kjo karakteristikë i dallon studimet rast-seri nga të gjitha studimet krahasuese, të cilat kanë karakter kryesisht analitik, sepse zakonisht konsistojnë në rekrutimin e të paktën një grupi tjetër krahasimori cili përqaset me grupin (kontigjentin) e pacientëve të interesit. Studimet krahasimore ose analitike të udhëhequra në individë janë të llojeve të ndryshme bazuar kjo në drejtimin e studimit: drejtim prospektiv ose longitudinal (këtu përfshihen studimet kohort, ose studimet që vlerësojnë incidencën/dinamikën e pasojave/ngjarjeve shëndetësore); drejtim retrospektiv (studimet rast-kontroll); ose studime jo-drejtimore (studimet transversale, ose kros-seksionale) (296).

Pavarësisht nga karakteri kryesisht deskriptiv (përshkrues), studimet rast-seri kanë një përdorim dhe domethënie shumë të madhe në punën kërkimore-shkencore të mjekësisë klinike. Në këtë mënyrë, studime të tilla ofrojnë informacion shumë të vlefshëm i cili gjeneron hipoteza të rëndësishme, por edhe të dhëna që aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të pacientëve dhe/ose përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në popullatë.

Megjithatë, këto studime duhen udhëhequr me shumë seriozitet dhe skrupulozitet shkencor që në fazën e rekrutimit (përzgjedhjes) së pacientëve në studim për të garantuar përfaqësueshmëri dhe, në këtë mënyrë, përgjithësim të rezultateve të studimit (296).

Duke përmbledhur të gjitha konsideratat e parashtuara më lart, studimi aktual rast-seri konsistoi në përfshirjen e një kontigjenti (grupi) jo të njëpasnjëshëm por përfaqësues të pacientëve të diagnostikuar me Cirrozë Hepatike në Spitalin Rajonal Durrës gjatë një periudhe kohore të paracaktuar.

3.2 Periudha kohore e kryerjes (realizimit) të punimit shkencor

Ky studim u realizua në Spitalin Rajonal Durrës në periudhën Janar 2011 – Dhjetor 2014 (pra, me një kohëzgjatje prej katër vitesh kalendarik).

3.3 Popullata në studim

Popullata e përfshirë në këtë studim konsistoi në një kontigjent (grup) prej 200 rastesh (pacientësh) të shtruar pranë Spitalit Rajonal Durrës.

Në këtë mënyrë, ky studim shfrytëzoi rastet e paraqitura në spitalin e sëmundjeve gastro-intestinale, në bashkëpunim me mjekët gastrohepatologë, kirurgët abdominalë, shërbimin e

anatomisë patologjike në bazë të një protokollit paraprak bashkangjitur një karteletip për mbledhjen e të dhënave.

Për të të rritur fuqinë e studimit, si dhe duke marrë në konsideratë refuzimet e mundshme të pacientëve për pjesëmarrje në studim (pacientë të cilët mund të ishin shumë të sëmurë ose do t'a kishin të pamundur pjesëmarrjen në studim për arsye të tjera), u vendos që të rekrutoheshin (përfshiheshin) 200 pacientë jo të njëpasnjëshëm që do të diagnostikoheshin me Cirrozë Hepatike pranë Spitalit Rajonal Durrës.

Në total, shkalla e pjesëmarrjes në studim në kampionin e pacientëve ishte e lartë: 200 pacientë.

Kjo pjesëmarrje në studim konsiderohet shumë e lartë dhe është në përputhje edhe me studime të tjera të udhëhequra në vendin tonë dhe duhet theksuar se është shumë më e lartë në krahasim vendet e tjera të rajonit tonë.

Nga 200 pacientë të përfshirë në këtë studim, 39 (19.5%) individë ishin femra kundrejt 161 (80.5%) subjekteve meshkuj.

Në tërësi, moshë mesatare e pacientëve të përfshirë në studim ishte 58 ± 9 vjeç dhe nuk kishte ndryshim domethënës (sinjifikativ) në vlerën e moshës mesatare sipas gjinisë së pacientëve (në meshkuj, moshë mesatare ishte: 58.1 ± 9.2 vjeç, ndërsa në femra moshë mesatare ishte: 58.4 ± 9 vjeç).

Duhet theksuar se, kampioni përfundimtar i pacientëve të të dy gjinive të përfshirë në këtë punim mundësoi plotësisht realizimin e objektivave dhe përmbushjen e qëllimit përfundimtar të studimit.

3.4 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave të këtij studimi konsistoi në marrjen e anamnezës, ekzaminimin e hollësishëm klinik, procedurat e ekzaminimeve laboratorike dhe imazherike si dhe në administrimin e një pyetësori të strukturuar tek të gjithë pacientët me komplikacione të cirrozës hepatike të përfshirë në këtë studim.

Kontrolli ose verifikimi i cilësisë së mbledhjes së të dhënave u realizua përmes verifikimit të procedurave të punës dhe konsistoi në vlerësimin e cilësisë së informacionit të përshkruar në kartelat klinike, repertin e plotë diagnostik (imazherik dhe laboratorik), si dhe në vlerësimin e mënyrës së administrimit të pyetësorit tek të gjithë pacientët me cirrozë hepatike të përfshirë në studim. Procedurat kryesore për përcaktimin e diagnozës së Cirrozës Hepatike dhe komplikacioneve të saj në këtë studim konsistuan në ekzaminimet imazherike dhe ato laboratorike.

Ekografia abdominale u realizua pa një përgatitje të vecantë për individët që ishin aktivë dhe në raste të vecanta, u realizua ekografia në shtratin e pacientit për rastet që nuk kishin mundësi për të lëvizur.

Procedura e ekzaminimit me CT skaner u realizua pa lëndë kontrasti, si edhe me kontrast intravenoz. Përgjithësisht, ekzaminimi përmes CT skanerit nuk kërkon përgatitje specifike të pacientëve dhe ky ekzaminim karakterizohet nga një shkallë bashkëpunimi shumë e mirë mes stafit dhe subjekteve të ekzaminuar.

Parimisht, ekzaminimi CT skaner ka sikundër-indikacion ekspozimin ndaj rrezatimit, por në rastet kur dyshohet për një patologji si cirroza hepatike e cila më tej përforcon klinikën me shfaqjen e komplikacioneve të saj duhet të kryhet patjetër.

Fibrogastroskopia është një tjetër ekaminim me vlerë pasi bën të mundur vlerësimin e variceve ezofageale, një komplikacion ky i cirrozës hepatike që në raste të hemoragjive akute mund të rezultojë jetëkërcënues. Gjithashtu me anë të FGS bëhet e mundur edhe trajtimi i variceve ezofageale nëpërmjet procedurës së skleroterapisë së variceve.

Rezonanca Magnetike është një tjetër ekzaminim me vlerë në vlerësimin e Cirrozës Hepatike pasi ka sensitivitet të lartë në diagnostikimin e Hepatokarcinomës në faza të hershme. Në fakt ky modalitet indikohet edhe për vlerësimin e Cirrozës Hepatike por shpeshherë pacientët paraqesin vështirësi për të bashkëpunuar gjaktë realizimit të ekzaminimit si dhe është një ekzaminim me kosto të lartë.

Nga ana tjetër, pyetëtori i studimit përfshiu pyetje bazë të lidhura kryesisht me karakteristikat demografike (mosha dhe gjinia), faktorët e lidhur me mënyrën e jetesës (me fokus kryesor vlerësimin e konsumimit të alkoolit lidhur me kohëzgjatjen, frekuencën, intensitetin dhe sasinë e konsumuar), dhe sidomos profilin klinik të pacientëve (sëmundjeve të tjera shoqëruese, nëse kishte ndonjë të tillë të pranishme).

3.5 Përkufizimi i variablave

Në këtë rubrikë përshkruhet përkufizimi operacional i aplikuar për përcaktimin klinik të diagnozës kryesore, të patologjive të tjera shoqëruese, si dhe i të gjitha karakteristikave klinike, faktorëve të riskut dhe të dhënave social-demografike për të gjithë individët e përfshirë në studim.

Çdo e dhënë apo pjesëz informacioni e përfshirë në një studim shkencor kuantitativ (sasior) emërtohet si “variabël” (ose, “ndryshor”). Edhe në këtë studim u përfshinë disa variable (ndryshorë) social-demografikë, faktorë risku dhe shumë të dhëna klinike me rëndësi për diagnozën, karakterizimin dhe profilizimin klinik të cirrozës hepatike.

Më konkretisht, përkufizimi i këtyre variabëve (ndryshorëve) të përfshirë në studimin aktual paraqitet më poshtë:

- Karakteristikat demografike:

- **Mosha:** u vlerësua sipas vetë-raportimit të datës së lindjes të individëve dhe datës së ekzaminimit, apo vendosjes në kartelën klinike (ose, datës së intervistimit të subjekteve në

raste te caktuara). Në analizën e të dhënave, mosha u trajtua si variabël *numerik*, por edhe si variabël *ordinal* në grup-mosha të ndryshme (≤ 60 , 61-70, dhe ≥ 71 vjeç).

- **Gjinia:** ky është një variabël *nominal* i nën-tipit *binar/dikotomik*– pra, variabël me vetëm dy kategori (meshkuj vs. femra).

- Faktorët e riskut:

- **Konsumimi i alkoolit:** statusi i pijedashës sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Periudha e konsumimit të alkoolit:** kohëzgjatja e konsumit të alkoolit (në vite); variabël *numerik* diskret (në vite të plota).
Në analizën e të dhënave, periudha e alkoolizimit u trajtua edhe si variabël *ordinal* në tri kategori të ndryshme (< 10 , 10-20, dhe mbi 20 vjet).
- **Historia familjare:** sipas vetë-raportimit të pacientëve nga anamneza, për histori familjare të patologjive të trashëguara hepatike; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).

- Të dhëna të tjera nga anamneza:

- **Hepatiete virale B,C,D:** sipas anamnezës së subjekteve në studim; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Sëmundje e mëparshme hepatike:** sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Lloji i sëmundjeve të mëparshme (të tjera):** vetëm për individët që raportuan sëmundje të mëparshme hepatike ose të trakteve të tjera; variabël *nominal*: Hepatiti kronik viral B,C,D, Hepatiti autoimun, Steatohepatiti jo etilic, Cirroza Kardiake, Sëmundjet metabolike të trashëguara, sëmundje të tjera.
- **Grupi i gjakut:** variabël *nominal*: 0-, 0+, A-, A+, B-, B+, AB.

- Simptomat klinike:

- **Dhimbje:** sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Temperaturë:** sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Dobësi:** sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Dhimbje artikulare:** sipas vetë-raportimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo).
- **Ikter:** sipas vetë-deklarimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo)
- **Yjet vaskulare:** sipas vetë-deklarimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo)
- **Eritemat palmare:** sipas vetë-deklarimit të individëve; variabël *dikotomik/binar* (po vs. jo)

- **Asciti:** sipas vetë-deklarimit të individëve; variabël dikotomik/binar (po vs. jo)
- **Edema periferike:** sipas vetë-deklarimit të individëve; variabël dikotomik/binar (po vs. jo)

3.6 Analiza Statistikore

Të gjitha të dhënat e mbledhura nga kartelat klinike dhe pyetësorët e pacientëve të diagnostikuar me cirrozë hepatike në këtë studim u hodhën në kompjuter në programin Microsoft-Excel, dhe më tej u transferuan në programin SPSS (*Statistical Package for Social Sciences, version 19.0*). Me këtë paketë statistikore (SPSS) u realizua e gjithë analiza e të dhënave.

Testet dhe modelet statistikore të përdorura në analizën e të dhënave të këtij studimi përshkruhen në mënyrë të detajuar më poshtë:

- Për të gjitha variablet (ndryshorët) *numerike* u llogaritën/njehsuan madhësitë e prirjes qendrore (mesatarja aritmetike dhe mediana) dhe madhësitë përkatëse të dispersionit (shmangia standarde dhe largësia interkuartile). Për të dhënat që i nënshtroheshin shpërndarjes normale, u raportuan *mesataret aritmetike ± deviacionet standarde* përkatëse, ndërsa për të dhënat që nuk i nënshtroheshin shpërndarjes normale, u raportua *medianat dhe largësitë interkuartile* përkatëse.
- Për të gjitha variablet (ndryshorët) kategorike (*nominale* përfshi shkallën *binare/dikotomike*, dhe/ose *ordinale*), u raportuan frekuencat/shpeshësitë (numrat absolutë) dhe proporcionet/përqindjet përkatëse.
- Testi “T” i Studentit (test parametrik) u përdor për krahasimin e vlerave mesatare mes dy grupeve, ose kategorive të ndryshme.
- Analiza e Variancës (ANOVA) u përdor për krahasimin e vlerave mesatare mes tre ose më shumë kategorive (grupeve) të ndryshme.
Nëpërmjet kësaj procedure u llogaritën vlerat mesatare të parametrave të grupevetë ndryshme (si dhe vlerat e sinjifikancës/përfillshmërisë statistikore për krahasimin e grupeve përkatëse).
- Testi hi-katror u përdor për krahasimin e proporcioneve (përqindjeve) për variablet kategorike.
- Në të gjitha rastet, u konsideruan si statistikisht sinjifikative (ose, të përfillshme) vlerat e $P \leq 0.05$.

IV Rezultatet

Në këtë kapitull paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha gjetjet (rezultatet) e studimit aktual sipas renditjes së mëposhtme:


- Përshkrimi i karakteristikave demografike të pacientëve me komplikacione të cirrozës hepatike të përfshirë në studim;
- Shpërndarja e faktorëve të riskut tek pacientët me komplikacione të cirrozës hepatike të përfshirë në studim;
- Përshkrimi i karakteristikave klinike të pacientëve me komplikacione të cirrozës hepatike të përfshirë në studim.
- Komplikacionet e Cirrozës Hepatike si pasojë e dilatacionit arterial dhe qarkullimit hiperdinamik

4.1 Përshkrimi i Karakteristikave Demografike të Pacientëve me Komplikacione të Cirrozës Hepatike

Gjinia

Në këtë punim 49 (19.5%) e rasteve ishin femra dhe 161 (80.5%) ishin meshkuj. Siç vihet re nga rezultatet e studimit tonë kemi një raport të ndjeshëm ndërmjet rasteve me cirrozë hepatike në pacientët meshkuj.

Grafiku nr 1. Ndarja gjinore në popullatën e marrë në studim.



Mosha

Tabela nr 2 përshkruan shpërndarjen e moshës në kontigjentin e pacientëve të përfshirë në studim. Në tërësi, mosha mesatare në kontigjentin e 200 pacientëve të përfshirë në studim ishte 58 ± 9 vjeç. Mediana ishte 61 vjeç. Individu me moshën më të re ishte 27 vjeç, ndërsa subjekti më i moshuar ishte 86 vjeç. Në këtë mënyrë, rangi i vlerave të moshës ishte 59 vjet ($86-27$), vlerë e cila përbënte

edhe modën (vlerën më frekvente, ose të shpeshtë) të këtij vargu numerik. Moshë mesatare tek pacientët e gjinisë mashkullore ishte 58.1±9 vjeç ndërsa moshë mesatare tek pacientët e gjinisë femërore ishte 58.4±9 vjeç.

Tabela nr 2. Shpërndarja e moshës tek pacientët në studim

| | | |
|----------------|-------|------|
| Number | Valid | 200 |
| Mean | | 58.3 |
| Mode | | 59.0 |
| Std. Deviation | | 9.00 |
| Minimum | | 27 |
| Maximum | | 86 |

Nuk ka evidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në vlerën mesatare të moshës sipas gjinive: kështu, vlera e moshës mesatare ishte sinjifikativisht e njëjtë tek meshkujt në krahasim me femrat 58± 9 vjeç (testi T i Studentit: P<0.001;)

Grupmoshat e pacientëve në studim

Për qëllime lehtësimi të studimit u bë e mundur ndarja e pacientëve në grupmosha nga ku u studiua grupmosha me numrin më të lartë të rasteve.

Tabela nr 3 Shpërndarja e grup-moshës së subjekteve në studim.

| Moshë/ Nr rastesh | ≤ 30 vjeç | 31-40 vjeç | 41-50 vjeç | 51-60 vjeç | 61-70 vjeç | 71 e lart |
|-------------------------|-----------|---------------|---------------|---------------|---------------|-----------|
| | 3 raste | 4raste | 42 raste | 78 raste | 38 raste | 35 raste |
| Totali | | | | | | 200 raste |

Kishte evidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në grup-moshën 51- 60 vjeç në individët sipas klasifikimit të grupmoshave në studim (testi hi-katror: P=0.002).

Në tërësi, 127 pacientë ishin me moshë ≤60 vjeç, 38 subjekte ishin me moshë 61-70 vjeç dhe pjesa tjetër prej 35 pacientë ishin me moshë 71 vjeç e lart. Shpeshtësia më e madhe e rasteve i përket grupmoshës 51-60 vjeç. Bazuar në rezultatet e studimit sa i përket grupmoshave me frekuencën më të lartë vihet re një rritje e ndjeshme e rasteve në pacientët mbi 60 vjeç.

Vëndbanimi

Vëndbanimi i pacientëve të marrë në studim u studiua: zonë rurale dhe zonë urbane për të vërtetuar nëse ka një korelacion ndërmjet këtij treguesi me zhvillimin e sëmundjes të marrë në studim.


Tabela nr 3 Shpërndarja gjinore e pacientëve sipas vëndbanimit.

| | |
|-------|---------|
| Femra | Meshkuj |
|-------|---------|

| | <i>Nr.</i> | <i>%</i> | <i>Nr.</i> | <i>%</i> | <i>Total</i> |
|---------------------|------------|----------|------------|----------|--------------|
| <i>Fshat</i> | 24 | 62% | 67 | 42% | 91 |
| <i>Qytet</i> | 15 | 38% | 94 | 58% | 109 |
| Total | 39 | 100% | 161 | 100% | 200 |

Në bazë të rezultateve të tabelës vihet re që 62% e rasteve në femra me cirrozë hepatike janë në zonat rurale; ndërsa në meshkuj numri më i lartë i rasteve vjen në individet e marrë në studim të cilët jetojnë në qytet dhe zona të zhvilluara, kryesisht 58% e rasteve.

Grafiku nr 2. Vëndbanimit në zonë rurale dhe urbane.



Kishte evidencë të një ndryshimi statistikiqsh sinjifikativ në individët që jetojnë në zonat rurale me ato në zonat urbane (testi hi-katror: $P > 0.002$).

Mosha mesatare në zonat rurale dhe urbane.

Mosha mesatare e popullatës së diagnostikuar me cirrozë hepatike në total është 58 ± 9 vjeç, nga të cilat mosha mesatare e pacientëve që jetojnë në fshat është 57 vjeç ndërsa rastet që jetojnë në qytet kanë një moshë mesatare 60 vjeç. Siç vihet re nga të dhënat sa i përket moshës mesatare të pacientëve mosha mesatare e femrave që jetojnë në zonat rurale është më e re se në pacientet e së njëjtës gjini që jetojnë në zona urbane. Nga ana tjetër, mosha mesatare në meshkujt të cilët jetojnë në qytet është më i ulët se pacientët e së njëjtës gjini të cilët jetojnë në zona rurale.

Tabela 4 Mosha mesatare e popullatës sipas vendbanimit

| Gjinia | <i>Mosha Mesatare</i> | <i>Devijimi nga mosha mesatare</i> | <i>Fshat</i> | <i>Qytet</i> |
|-----------------|-----------------------|------------------------------------|--------------|--------------|
| <i>F</i> | 58 | 9 | 56 | 61 |
| <i>M</i> | 58 | 9 | 58 | 58 |

| | | | | | |
|------------|----------|----|---|----|----|
| Mosha | mesatare | 58 | 9 | 57 | 60 |
| popullates | | | | | |

Ka evidencë të një ndryshimi statistikiht sinjifikativ në moshën mesatare të popullatës që jetojnë në fshat sipas klasifikimit të vëndbanimit në studim (testi hi-katror: P=0.003).

4.2 Shpërndarja e faktorëve të riskut tek pacientët me Komplikacione të Cirrozës Hepatike


Faktorët predispozues për zhvillimin e Cirrozës Hepatike

Tabela nr 5 evidenton shkaktarët kryesorë që konsiderohen si faktorë risku për zhvillimin e Cirrozës Hepatike në target grupin e pacientëve në studimin tonë. Normalisht spektri i shkaktarëve është më i gjërë por ne do të bazohemi në anamnezën e pacientëve të marrë në studim. Nga të dhënat vihet re që pjesa më e madhe e rasteve 102 (51%) e pacientëve kanë referuar konsumin e alkoolit si factor predispozues, pasuar nga sëmundja virale e Hepatitit B, Hepatiti C etj.

Tabela nr 5. Shpërndarja e popullatës sipas faktorit predispozues për Cirrozë Hepatike

| Shkaku | Nr. | Nr në% |
|--------------------|------------|-------------|
| <i>Alkooli</i> | 102 | 51% |
| <i>Autoimun</i> | 2 | 1% |
| <i>HBV</i> | 66 | 33% |
| <i>HCV</i> | 14 | 7% |
| <i>Kriptogjene</i> | 16 | 8% |
| Total | 200 | 100% |

Grafiku nr 3. Shpërndarja e popullatës sipas shkakut.



Kishtevidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në factorët predispozues në individët në studim (testi hi-katror: $P>0.02$).

Përdorimi i alkoolit në pacientë femra dhe meshkuj


Tabela 6 dhe grafiku 4 paraqesin shpërndarjen e konsumimit të pijeve alkoolike sipas gjinisë së pacientëve të përfshirë në studim.

Prevalenca e konsumimit të alkoolit ishte shumë më e lartë tek meshkujt në krahasim me femrat 51% e popullatës të marrë në studim ka konsumuar alkool, nga të cilët 47% janë pacientë meshkuj dhe 4% paciente femra. Nga ana tjetër në 49% e popullatës alkooli nuk referohet factor predispozues për zhvillimin e patologjisë së marrë në studim. Alkooli si faktor është i lidhur ngushtë me faktorët socio-ekonomikë, kulturorë dhe me nivelin e arsimimit të popullsisë së një vëndi.

Tabela nr 6. Prevalenca e konsumimit të alkoolit sipas gjinisë së pacientëve

| Konsumimi alkoolit | | Seksi | | Total |
|--------------------|------------|---------------|-------------|-------|
| | | Meshkuj Nr(%) | Femra Nr(%) | |
| Po | 94(47%) | 8(4.0%) | 102(51%) | |
| Jo | 67(33.5) | 31(15.5%) | 98(49%) | |
| Total | 161(80.5%) | 39(19.5%) | 200(100.0) | |

Grafiku nr.4 Shpërndarja e popullatës konsumatore sipas gjinisë



Ky ndryshim mes meshkujve dhe femrave në prevalencën e konsumimit të alkoolit ishte statistikisht shumë sinjifikativ (testi hi-katror: $P < 0.001$).

Shpërndarja e sëmundjeve virale infective në pacientët e marrë në studim.


Hepatiti Viral B dhe shpeshtësia e tij në pacientët në studim

Tabela 7 parqet shpërndarjen e Hepatit Viral B në kontigjentin e pacientëve me Cirrozë Hepatike. Në tërësi nga të dhënat e evidentuara 66 pacietë (33%) me diagnozë Hepatit Viral B kanë zhvilluar Cirrozë Hepatike. Nisur edhe nga dëmtimi që Hepatiti B sjell në Hepar si në aspektin funksional ashtu edhe anatomic vihet re që ka një lidhje të drejtë ndërmjet agjentit viral B dhe zhvillimit të sëmundjes së marrë në studim.

Tabela 7 Prevalenca e Hepatit Viral B në Cirrozën Hepatike

| Prania e Hepatitit B | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|----------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 66 | 33 | 33.0 |
| Jo | 134 | 67 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 5.Rastet e evidentuara me Hepatit B



Kishte evidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në zhvillimin e hepatitit B si factor predispozues në individët në studim (testi hi-katror: $P = 0.02$).

Hepatiti Viral C


Tabela 8 parqet shpërndarjen e Hepatit Viral C në kontigjentin e pacientëve me Cirrozë Hepatike

Në tërësi nga të dhënat e evidentuara 95 (48%) raste me diagnozë Hepatit Viral C kanë zhvilluar Cirrozë Hepatike.

Tabela nr 8. Prevalenca e Hepatit Viral C në Cirrozën Hepatike

| Prania e Sëmundjeve Hepatike | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 14 | 7% | 7.0 |
| Jo | 186 | 93% | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 6. Rastet me Hepatit Viral C



Kishte evidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në vlerësimin e Hepatitit C si factor predispozues në individët në studim (testi hi-katorr: $P > 0.001$).

Cirroza Autoimune


Tabela nr 9 paraqet shpërndarjen e Cirrozës Autoimune në kontigjentin e pacientëve me Cirrozë Hepatike.

Në tërësi nga të dhënat e evidentuara 2 (1%) raste me diagnozë Hepatit Autoimun kanë zhvilluar Cirrozë Hepatike.

Tabela nr 9 Prevalenca e Cirrozës Autoimune në Cirrozën Hepatike

| Prania e Sëmundjeve Hepatike | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 2 | 1 | 1 |
| Jo | 198 | 99 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 7. Paraqitja grafike e rasteve me Cirrozë Autoimune



Kishte evidencë statistikore ndërmjet rasteve me cirrozë autoimune (testi hi-katror: $P=0.1$).


Faktorët Kriptogjenë

Tabela 10 evidenton shpërndarjen e Faktorëve Kriptogjenë në zhvillimin e Cirrozës Hepatike në popullatën e marrë në studim. Kështu, nga të dhënat e evidentuara në popullatën tonë të studimit 16 (8%) rasteve kanë zhvilluar Cirrozë Kriptogjene.

Tabela 10 Prevalenca e Cirrozës Kriptogjene

| Prania e Cirrozës Kriptogjene | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|-------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 16 | 8 | 8 |
| Jo | 184 | 92 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 8 . Paraqitja grafike e Cirrozës Kriptogene



Kishte evidencë statistikore sinjifikative në vlerësimin e cirrozës kriptogene në individët në studim (testi hi-katror: $P < 0.004$).


Sëmundje të tjera shoqëruese

Tabela 11 paraqet shpërndarjen e llojeve të ndryshme të sëmundjeve shoqëruese në kontigjentin e pacientëve me Cirrozë Hepatike të përfshirë në këtë punim, me përjashtim të sëmundjeve Hepatike Virale (që u përshkruan më lart).

Tabela 11. Prevalenca e sëmundjeve shoqëruese

| Sëmundjet shoqëruese | Numri | Përqindja |
|----------------------|-------|-----------|
| Obeziteti | 26 | 13.0 |
| Sindromi metabolik | 9 | 4.5 |
| Diabet | 31 | 15.5 |
| Të tjera | 72 | 36.0 |
| Total | 138 | 69 |
| Missing | 62 | 31 |
| Total | 200 | 100.0 |

Grafiku nr 9. Paraqitja grafike e rasteve me sëmundje shoqëruese



Kishte evidencë të një ndryshimi statistikisht sinjifikativ në vlerësimin e sëmundjeve shoqëruese si factor predispozues në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.002$).

4.3 Përshkrimi i Karakteristikave Klinike të Pacientëve me Komplikacione të Cirrozës Hepatike

Në këtë pjesë të studimit do të studiohen shenjat klinike më të shpeshta të pacientëve me Cirrozë Hepatike duke u mbështetur në rastet klinike reale, të prekshme të studimit tonë. Ndër shenjat klinike me frekuencën më të lartë të hasur në grupin tonë të studimit kemi ikterin, edemat periferike etj.

Ikteri


Është shenja klinike me prevalencën më të lartë në rastet tona në studim. Nga kontigjenti ynë prej 200 rastesh 186 (93% raste referojnë të kenë kaluar episode ikterik. Kjo shenjë klinike evidenton një pacient me probleme hepatologjike në proces. Në studimin tonë ikteri është shenja që konsiderohet si këmbanë alarmi për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve.

Tabela nr 12 evidenton rastet me ikter në popullatën tonë në studim.

Tabela nr 12. Nr rasteve që kanë zhvilluar ikter

| Prezenca e Ikterit | Numri rasteve | Numri rasteve në % | % kumulative |
|--------------------|---------------|--------------------|--------------|
| PO | 186 | 93% | 93.0 |
| JO | 14 | 7% | 100 |
| TOTAL | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr.10 Paraqitja grafike e të sëmurëve me Ikter



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e ikterit si shenjë klinike në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P>0.001$).

Yjet vaskularë


Tabela nr 13 paraqet shpërndarjen e rasteve me yjeve vaskulare në kontigjentin e pacientëve me komplikacione të Cirrozës Hepatike të përfshirë në këtë punim. Nga kontigjenti i 200 rasteve 87 raste paraqiten me zhvillim të yjeve vaskularë si pasojë e crregullimit të qarkullimit të gjakut periferik.

Tabela nr 13. Prevalenca e yjeve vaskularë tek pacientët në studim

| Prevalenca e yjeve vaskularë | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 87 | 43.5 | 43.5 |
| Jo | 117 | 58.5 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Në total, vetëm 87 (43.5%) e pacientëve kishin prani të yjeve vaskularë, ndërsa pjesa më e madhe prej 117 (58.5%) e subjekteve nuk kishin yje vaskularë.

Grafiku nr 11. Paraqitja grafike e prevalencës së zhvillimit të yjeve vaskularë.



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e yjeve vaskulare si shenjë klinike në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.03$).


Edemat periferike

Tabela nr 14 paraqet shpërndarjen edemave periferike në kontigjentin e pacientëve me komplikacione të cirrozës hepatike të përfshirë në këtë punim. 112 (56%) referojnë se kanë zhvilluar edemë periferike gjatë zhvillimit të sëmundjes.

Tabela nr 14. Edemat periferike si shenjë klinike e cirrozës hepatike

| Prevalenca e edemave periferike | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|---------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 112 | 56.0 | 56.0 |
| Jo | 88 | 44.0 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 12. Paraqitja grafike e rasteve me edema periferike



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e edemave periferike si shenjë klinike në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.02$).


Shenja klinike të tjera

Tabela 15 paraqet shpërndarjen e shenjave klinike pas ekzaminimit fizik në kontigjentin e pacientëve me Cirrozë Hepatike të përfshirë në këtë punim. Në total, 78 (39% e pacientëve me vlera për këtë variabël) kishin prani të foetor hepaticus; 38 (19.0%) pacientë kishin zhvilluar purpura; një kontigjent prej 67 (33.5%) të subjekteve kishin eritema palmare ; dhe vetëm 15 (7.5%) e pacientëve kishin zhvilluar gishtërinjtë si shkop tamburi.

Tabela nr 15. Shenja klinike të tjera

| Shenja Klinike | Numri | Përqindja |
|-------------------------------|-------|-----------|
| Foetor Hepaticus | 78 | 39.0 |
| Purpura | 38 | 19.0 |
| Eritema palmare | 67 | 33.5 |
| Gishtërinjte si shkop tamburi | 15 | 7.5 |
| Total | 198 | 99.0 |
| Missing | 2 | 1.0 |
| Total | 200 | 100.0 |

Grafiku nr 13. Paraqitja grafike e shenjave klinike më pak të zhvilluara.



4.4 Komplikacionet e Cirrozës Hepatike si pasojë e dilatacionit arterial dhe qarkullimit hiperdinamik.

Komplikacionet më të shpeshta në grupin e pacientëve që iu nënshtruan studimit janë asciti, encefalopati hepatike, hemoragji nga varicet ezofageale që do të diskutojmë në këtë sesion të punimit tonë.

Komplikacionet e Cirrozës Hepatike


Ndër komplikacionet me frekuencën më të lartë në studimin tonë janë paraqitur asciti, varicet ezofageale, hemoragjia e variceve ezofageale, encefalopatia hepatike, sindromi hepatorenal. Kështu, kemi 168 (84%) të rasteve që janë paraqitur me Ascit, 148 (74%) të rasteve me Variçe Ezofageale, 108 (54%) me Encefalopati Hepatike, Sindromi Hepatorenal ka qënë prezent në 56 (28%) të pacientëve.

Tabela nr 16. Komplikacionet më të shpeshta në Cirrozën Hepatike

| Komplikacioni | Nr rasteve | Nr rasteve në % |
|---------------|------------|-----------------|
| Ascit | 168 | 84 |

| | | |
|--|-----|----|
| Varice ezofageale | 148 | 74 |
| Hemoragji GI nga varicet ezofageale | 46 | 23 |
| Encefalopati hepatike | 108 | 54 |
| Sindromi Hepatorenal | 56 | 28 |

Grafiku nr 14.Paraqitja grafike e komplikacioneve më të shpeshta në Cirrozën Hepatike




Asciti

Asciti përbën ndërlikimin e parë me frekuencën më të lartë dhe në studimin tonë ky variabël u evidentua në 168 (84%) të rasteve. Shkaktari primar i ascitit është hipertensioni portal dhe dekompensimi i cirrozës hepatike e ka mjaft të shprehur si process.

Tabela nr 17 eidenton prevalencën e pacientëve që kanë zhvilluar ascit

| Prevalenca e Ascitit | Numri | Përqindja | Përqindja kumulative |
|-----------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 168 | 84 | 84 |
| Jo | 32 | 16.0 | 100.0 |
| Total | 199 | 99.5 | |
| Missing System | 1 | 0.5 | |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 15.Paraqitja grafike e pacientëve me Ascit



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e ascitit si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.03$).


Varicet Ezofageale

Tabela nr18 evidenton prevalencën e pacientëve me Varice Ezofageale, konkretisht në punimin tonë janë evidentuar 148 (74%) të rasteve me këtë komplikacion të rëndë.

Tabela nr 18. Prania e variceve ezofageale

| Prevalenca e Variceve Ezofageale | Numri | Përqindja | Përqindja kumulative |
|----------------------------------|-------|-----------|----------------------|
| Po | 148 | 74.0 | 74.0 |
| Jo | 52 | 26 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 16. Paraqitja grafike e rasteve me variceve ezofageale.



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e variceve ezofageale si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.001$).


Ascit + Varice Ezofageale

Tabela 20. Evidenton prevalencën e pacientëve që kanë zhvilluar Ascit dhe Varice ezofageale të kombinuara ndërmjet tyre. Me këto variabla janë paraqitur 83 (42%) të rasteve.

Tabela nr 20. Rastet me Ascit dhe Varice Ezofageale.

| Ascit dhe varice ezofageale | Nr | Përqindja | Përqindja kumulative |
|-----------------------------|-----|-----------|----------------------|
| Të kombinuara | 83 | 42 | 42.0 |
| Jo të kombinuara | 114 | 57 | 100.0 |
| Total | 197 | 98.5 | |
| Missing System | 3 | 1.5 | |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 17 paraqet rastet me Ascit dhe Varice ezofageale.



Kishte evidencë statistikiisht sinjifikative në vlerësimin e ascit kombinuar me varice ezofageale si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: P= 0.2).


Varice Ezofageale + Hemoragji Gastro Intestinale

Tabela 21 evidenton rastet e pacientëve me Varice Ezofageale dhe Hemoragji Gastro Intestinale. Në studimin tonë janë paraqitur 46 (23%) me Hemoragji GI. Në fakt ky komplikacion akut është serioz dhe kërkon menaxhim të menjëhershëm pasi mund të ketë pasoja fatale për pacientin.

Tabela nr 21. Rastet me VE kombinuar me Hemoragji GI

| Varice Ezofageale + Hemoragji | Nr.rasteve | Nr.rasteve në % |
|-------------------------------|------------|-----------------|
| PO | 46 | 23% |
| JO | 154 | 77% |
| Totali | 200 | 100.0 |

Grafiku nr 18. Paraqitja grafike e rasteve me VE + HGI



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e variceve ezofageale kombinuar me hemoragji gastrointestinale si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P < 0.01$).


Ascit +Varice Ezofageale+ Hemoragji Gastro Intestinale

Tabela 22 Evidenton rastet të cilat kanë shfaqur ascit dhe varice ezofageale të kombinuara me hemoragji të traktit të sipërm gastrointestinal. Kështu në kontigjentin tonë në studim janë paraqitur me ndërthurje të komplikacioneve 45 (22.5%) të rasteve.

Tabela nr 22.Rastet e pacientëve me Ascit +Varice Ezofageale kombinuar me Hemoragji TGI

| Ascit+ varice ezofageale HGI | Nr | Përqindja | Përqindja kumulative |
|---------------------------------|-----|-----------|----------------------|
| Të kombinuara | 45 | 22.5 | 22.5 |
| Jo | 155 | 77.5 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 20 .Paraqitja grafike e rasteve me kombinim të Ascitit me VE+HGI



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e ascitit të kombinuar me varice ezofageale me hemoragji gastro-intestinale si komplikacione në individët me cirrozë hepatike (testi hi-katror: $P>0.01$).


Encefalopati Hepatike

Tabela 23 evidenton prevalencën e pacientëve që kanë zhvilluar Encefalopati Hepatike. Në kontigjentin e rasteve në studim 108 (54%) kanë zhvilluar encefalopati hepatike. Në përgjithsi Encefalopatia Hepatike dhe Asciti vijnë si pasojë e Hipertensionit Portal që nga ana tjetër si proves fizpatologjik nxit formimin e qarkullimit kolateral e më tej rritjen e fluksit splanknik të gjakut.

Tabela nr 23 tregon nr e rasteve që kanë zhvilluar encefalopati hepatike.

| Encefalopati Hepatike | Nr | Përqindja | Përqindja kumulative |
|-----------------------|-----|-----------|----------------------|
| Po | 108 | 54 | 54.0 |
| Jo | 92 | 46 | 100.0 |
| Total | 200 | 100.0 | |

Grafiku nr 21. Paraqitja grafike e Encefalopatisë Hepatike



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin e encefalopatisë hepatike si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P < 0.04$).


Sindromi Hepatorenal

Në studimin tonë janë paraqitur 56 (28%) raste me komplikacion Sindromi Hepatorenal. HRS është një komplikacion i shpeshtë i pacientëve me cirrozë hepatike dhe kërkon ndjekje në kohë për të parandaluar insuficiencën renale akute.

Tabela 24. Rastet e evidentuara me sindromën hepatorenale në studimin tonë.

| Sindromi Hepatorenal | Nr rasteve | Nr rasteve në % |
|----------------------|------------|-----------------|
| PO | 56 | 28% |
| JO | 144 | 72 |
| Totali | 200 | 100 |

Grafiku nr 22. Paraqitja grafike e shpeshtësisë së HSR



Kishte evidencë statistikisht sinjifikative në vlerësimin sindromit hepatorenal si komplikacion në individët me komplikacione të cirrozës hepatike (testi hi-katror: $P > 0.03$).

Child-Pugh


Tabela 25 paraqet analizën sipas sistemit të klasifikimit Child-Pugh për popullatën tonë në studim. Në total ka një mbizotërim të Child C 95 raste me gati gjysmën e pacientëve që është sinjifikante nga ana statistikore ($p < 0.05$ ne chi square)

Tabela 25 paraqet ndarjen e rasteve sipas sistemit Child

| | N | % | p value* |
|----------------------|----|------|----------|
| CHILD Classification | | | 0.001 |
| Child A | 26 | 13 | |
| Child B | 79 | 39.5 | |
| Child C | 95 | 47.5 | |

Grafiku nr 23. Paraqitja grafike e rasteve me Cirrozë Hepatike sipas sistemit Child

| Etiologjia | | | | |
|---------------------|----------|------|-------------|------|
| CHILD Clasification | Alkoolik | | Jo Alkoolik | |
| | n | % | n | % |
| Child A | 15 | 14.7 | 11 | 11.2 |
| Child B | 46 | 45 | 33 | 33.6 |
| Child C | 41 | 40.3 | 54 | 55.2 |



Ne total ka një mbizotërim të Child C me gati gjysmën e pacientëve që është sinjifikante nga ana statistikore ($p < 0.05$ në chi square)

Child-Pugh sipas etiologjisë së Cirrozës Hepatike

Tabela nr 26 tregon shpërndarja sipas e pacientëve sipas etiologjisë dhe klasifikimit Child. Nuk ka ndryshime sinjifikative në shpërndarjen e pacientëve sipas klasifikimit Child dhe etiologjisë së cirrozës. ($p > 0.05$ në chi square). Pra etiologjia e cirrozës nuk duket të ndikojë në ke kategori Child gjendet pacientëve.


Efekte të tjera të Cirrozës Hepatike

Tabela 27 studion efektet e tjera të cirrozës Hepatike në popullatën tonë në studim. Sipas rezultateve të punimit. Kështu Hidrotoraksi Spontan është paraqitur në 53 raste pasuar nga Hiponatremia me 50 raste.

Tabela nr 27 Efektet sekondare të Cirrozës Hepatike me disa variabla

| Efekte sekondare të Cirrozës Hepatike | Nr | Përqindja |
|---|-----|-----------|
| Hidrotoraksi Hepatik | 53 | 26.5 |
| Hiponatremia | 50 | 25.0 |
| Sindroma Hepatopulmonare | 30 | 15.0 |
| Insuficenca Kardiake nga debiti i rritur | 41 | 20.5 |
| Të tjera | 26 | 13.0 |
| Totali | 200 | 100 |

Grafiku nr 24. Paraqitja grafike e komplikacioneve të Cirrozës Hepatike



Hepatokarcinoma


Tabela 28 Evidentimi i rasteve me Hepatokarcinomë në subjektet që janë diagnostikuar me Cirrozë Hepatike. Ky variabël është i lidhur me faktorët etiologjikë të zhvillimit të sëmundjes së Cirrozës Hepatike, kryesisht me Hepatitin B dhe C.

Kështu në punimin tonë rezulton se në total kemi 65 raste me HCC (32.5%) të rasteve; nga këto 18 (9%) raste janë diagnostikuar me Hepatit B dhe 39 (19.5) raste janë diagnostikuar me Hepatit C. Rastet e tjera janë subjekte të cilët nuk kanë zhvilluar Hepatit B apo Hepatit C më parë.

Tabela nr 28. Korelacioni ndërmjet faktorit etiologjik të Cirrozës Hepatike dhe KHC

| Hepatokarcinoma | Nr rasteve | Përqindja |
|------------------|------------|-----------|
| Hepatit B | 18 | 9.0 |
| Hepatit C | 39 | 19.5 |
| Alkoolike | 8 | 4.0 |
| Total | 132 | 66.0 |
| Missing | 3 | 1.5 |
| Total | 200 | 100 |

Grafiku nr 25 .Paraqitja grafike e rasteve të KHC sipas etiologjisë




Vëndodhja e KHC në Hepar

Në këtë grup pacientësh, 32(49.1%) individë kishin lokalizim në lobin dexter të masës tumorale, ndërsa 18 (27.7%) e subjekteve kishin lokalizim në lobin sinister të masës tumorale, pasuar nga 15 raste (23%) në lobin caudat.

Tabela 29. Lokalizimi i masës tumorale në ekzaminimin me CT skaner

| Lokalizimi | Numri | Përqindja | Përqindja Kumulative |
|---------------|-------|-----------|----------------------|
| Lobi Dexter | 32 | 49.1 | 49.1 |
| Lobi Sinister | 18 | 27.7 | 100.0 |
| Lobi Caudate | 15 | 23.0 | |
| Totali | 65 | 100 | |

Grafiku nr 26. Paraqitja grafike e rasteve të KHC sipas vëndndodhjes anatomike në Hepar



4.1 Jetëgjatësia e pacientëve me komplikacione të cirrozës hepatike

Jetëgjatësia mesatare

Tabela 36 paraqet jetëgjatësinë mesatare të pacientëve nga momenti i diagnostikimit, ky është një kriter i cili shkon në varësi të disa variablave duke nisur nga faktorët etiologjikë, në komplikacionet e cirrozës hepatike. Në materialin e punimit tonë mesatarja e viteve jetë që një pacient me komplikacione post cirrotike është 6.2 vite jetë. Duhet theksuar që për dy raste nuk kemi informacion mbi vitin e vdekjes por pacienti ka ndërruar jetë, ndërsa për 140 raste nuk ka të dhëna nëse pacienti ka ndërruar jetë apo jo.

Tabela nr 30 paraqet jetëgjatësinë mesatare të pacientëve me cirrozë hepatike

| Nr.Rasteve | Jetëgjatesia nga momenti diagnostikimit (vite) |
|------------|--|
| 0 | 20 |
| 1 | 14 |

| | |
|----------------|------------|
| 2 | 4 |
| 3 | 5 |
| 4 | 3 |
| 5 | 3 |
| 6 | 4 |
| 7 | 3 |
| 8 | 1 |
| 12 | 1 |
| n/a | 140 |
| missing | 2 |
| Totali | 200 |

Nga të dhënat e evidentuara në tabelën 38, kemi 38(19%) të rasteve shikojmë që për pacientët me variabël jetëgjatësie të njohur


Raporti shkaktar/ jetë të humbura

Tabela 31. paraqet shpërndarjen e rasteve që kanë humbur jetën në korelacion me variablin e shkaktarit të Cirrozës Hepatike sipas ekzaminimit në kontigjentin e pacientëve me cirrozë hepatike të përfshirë në këtë punim. Nisur nga interpretimi të dhënave të evidentuara në tabelën 39 vihet re që kemi 60 (30%) humbje jete nga pacientët që morën pjesë në studim. Nga këto 23.5% e pacientëve me Cirrozë Alkoolike kanë humbur jetën, nuk ka asnjë humbje jete për periudhën e marrë në studim për pacientët me Cirrozë Hepatike Autoimune,; Pacientë me HBV 66 jetë të humbura; HCV 14 jetë të humbura, Faktori Kriptogen vjen me 16 jetë të humbura.

Tabela nr 31 paraqitja e rasteve të jetëve të humbura me shkaktarin e cirrozës hepatike

| Faktor Predispozues | Numri rasteve | Jetë të humbura |
|---------------------|---------------|-----------------|
| Alkoolik | 102 | 24 |
| Autoimun | 2 | 0 |
| HBV | 66 | 29 |
| HCV | 14 | 3 |
| Kriptogjene | 16 | 4 |
| Grand Total | 200 | 60 |

Grafiku nr 27.Paraqitja grafike e jetëve të humbura nga komplikacionet e Cirrozës Hepatike



Raporti vdekjeve sipas moshës mesatare dhe gjinisë

Në tabelën 32 është studiuar raporti vdekjeve në raport me gjininë (femër/mashkull) dhe moshën mesatare të pacientëve. Kanë zhvilluar rezulton se nga totali i jetëve të humbura 60, kemi 6 paciente femra të moshës ± 65 vjeç dhe 54 raste pacientë të gjinisë mashkullore me moshë mesatare ± 60 vjeç.

Tabela nr 32.Mosha mesatare e jetëve të humbura në gjininë F/M

| | Mosha mesatare | Nr | Nr në % |
|-----------------|----------------|----|---------|
| Jetë të humbura | 61 | 60 | 30.5% |
| Femra | 65 | 6 | 10 |
| Meshkuj | 60 | 54 | 90 |

V DISKUTIM

Në këtë kapitull do të përmbliidhen rezultatet kryesore të studimit aktual, do të diskutohen këto gjetje kryesore në raport me raportimet e literaturës ndërkombëtare mbi këtë fushë (d.m.th., lidhur me cirrozën hepatike dhe komplikacionet e saj), si dhe do të shqyrtohen disa nga epërsitë (avantazhet) dhe mangësitë potenciale të këtij studimi të realizuar në vendin tonë.

Ky studim analizon diferencën midis dekompensimit të parë në pacientet me cirrozë në lidhje me etiologjinë (alkoolike dhe joalkoolike), pasi menaxhimi klinik dhe prognoza në pacientët cirrotik mund të ndryshojë në varësi të etiologjisë dhe komplikacioneve të mëtejshme pas dekompensimit

